



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.148

dhjetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9659
datë 18.12.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), që lidhet me marrëveshjen e kredisë ndërmjet korporatës elektroenergjetike shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në kuadër të programit të Komunitetit të Energjisë të Europës Juglindore”..... 5967
.....

Ligj nr.9660
datë 18.12.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për pjesëmarrje në financimin e projektit “Ndërtimi i urës së Bunës, Shkodër”..... 5982

Ligj nr.9661
datë 18.12.2006

Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim”..... 5991

Ligj nr.9666
datë 18.12.2006

Për ratifikimin e një ndryshimi në “Marrëveshjen e tregtisë së lirë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në emër të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës”..... 6010

LIGJ
Nr.9659, datë 18.12.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), QË LIDHET ME MARRËVESHJEN E KREDISË
NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE BANKËS
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, NË KUADËR TË PROGRAMIT TË
KOMUNITETIT TË ENERGJISË TË EUROPËS JUGLINDORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), që lidhet me marrëveshjen e kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në kuadër të programit të Komunitetit të Energjisë të Europës Juglindore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5172, datë 28.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE GARANCIE
**(PROJEKTI I REHABILITIMIT TË NËNSTACIONEVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Marrëveshje e datës 2006 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka)

HYRJE

Meqenëse Garantuesi dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare kanë kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

meqenëse në bazë të marrëveshjes së huasë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare si Huamarrës dhe Bankës (Marrëveshja e huasë sipas parashikimit të termave dhe kushteve standarde), Banka ka rënë dakord t’i japë Huamarrësit një hua në shumën 16 000 000 euro, në përputhje me termat dhe kushtet e caktuara në marrëveshjen e huasë, me kusht që Garantuesi të garantojë përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huasë, në përputhje dhe me këtë Marrëveshje;

meqenëse Garantuesi, duke vlerësuar lidhjen e marrëveshjes së huasë nga Banka me Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë përmbushjen e detyrimeve të tilla për Huamarrësin,

për sa më sipër, Palët më poshtë bien dakord si vijon:

Neni 1

Termet dhe kushtet standarde, përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës së datës 1 maj 2006 janë përfshirë në këtë Marrëveshje, si dhe janë bërë të zbatueshme me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur janë pasqyruar plotësisht këtu (këto dispozita do të quhen më tej “Termet dhe kushtet standarde”).

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që të haset në këtë Marrëveshje (duke përfshirë si hyrjen, ashtu edhe Listet), vetëm nëse është thënë me kuptim tjetër, apo ka kuptim tjetër në kontekst, termat e përcaktuar në hyrje kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë aty, termat e përcaktuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë aty, ndërsa termat shtesë të mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Përfaqësuesi i autorizuar i Garantuesit” do të thotë Ministri i Financave i Garantuesit.

“Programi i asistencës menaxheriale” do të thotë programi i asistencës për menaxherët kryesorë të Huamarrësit dhe OST-së e ngritur prej Huamarrësit sipas termave dhe kushteve të kënaqshme për Bankën.

“Strategjia Kombëtare e Energjisë” do të thotë strategjia e miratuar nga Qeveria e Shqipërisë në qershor 2003, e cila identifikon investimet prioritare, nevojat për financime, si dhe reformat e kërkuara në sektorin energjetik, siç mund të amendohen herë pas here.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje referenca për një nen ose seksion të caktuar, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të konsiderohet si referencë për këtë nen ose seksion të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Garancia, detyrime të tjera

Seksioni 2.01 Garancia

Garantuesi këtu garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si i detyruari kryesor dhe jo thjesht si garant, pagimin e përpiktë të çdo dhe të gjitha shumave sipas marrëveshjes së huasë, qoftë në momentin e maturimit, me parapagim ose ndryshe, si edhe përmbushjen e përpiktë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, ashtu siç janë parashtruar në marrëveshjen e huasë.

Seksioni 2.02 Përfundimi i projektit

a) Kurdo që të ketë një shkak të arsyeshëm për të besuar se fondet e vëna në dispozicion Huamarrësit do të jenë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e llogaritura për kryerjen e projektit, Garantuesi do të marrë në mënyrë të menjëhershme masa të kënaqshme për Bankën për t'i siguruar Huamarrësit, ose do të bëjë që t'i sigurohen Huamarrësit fondet që janë të nevojshme për të përballuar këto shpenzime ose detyrime.

b) Pa kufizuar përgjithësinë e cilësdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje apo të termave dhe kushteve standarde, Garantuesi do të autorizojë Huamarrësin të vërë në jetë, aq herë sa do të jetë e nevojshme, rregullime në nivelin dhe strukturën e tarifave të Huamarrësit, me qëllim sigurimin se Huamarrësi është në gjendje të përmbushë detyrimet e veta në përputhje me seksionet 3.01(c) dhe 3.01(d) të marrëveshjes së huasë.

Seksioni 2.03 Detyrime të tjera

Garantuesi:

a) do të shmangë vënien e çdo takse direkte ose indirekte ndaj konsulentëve të huaj të punësuar nga Banka ose Huamarrësi në zbatim të projektit dhe të financuar nga të ardhurat e huasë ose nga çdo fond tjetër i bashkëpunimit teknik i vënë në dispozicion nga Banka;

b) do të zbatojë masat e rekomanduara nga strategjia kombëtare e energjisë;

c) do të zbatojë masat që do të merren nga Qeveria e Shqipërisë të rekomanduara nga plani i veprimit dhe do të mbështesë zbatimin e planit të veprimit prej Huamarrësit;

d) do të shmangë ndërhyrjen në praktikat standarde të arkëtimit të Huamarrësit;

e) do t'i paguajë Huamarrësit shumat e prapambetura të institucioneve buxhetore dhe

ndërmarrjeve shtetërore siç është rënë dakord në planin e veprimit, pagesa e fundit e të cilave në datën 31 dhjetor 2007 do të bëjë bilancin e detyrimeve të prapambetura zero;

f) me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, do të mbështesë zbatimin e programit të asistencës menaxheriale në një mënyrë të kënaqshme për Bankën;

g) do t'i japë Huamarrësit të drejtën e eliminimit të arkëtimeve të pambledhura nga faturat e energjisë elektrike, në një mënyrë që përputhet me praktikatat standarde industriale dhe në përputhje me planin e veprimit;

h) do të sigurojë ose bëjë që të sigurohen, kur të kërkohet, të gjitha licencat shtetërore, miratimet apo rënien dakord të kërkuar prej Huamarrësit për financimin dhe vazhdimin e projektit, si dhe vazhdimin e biznesit, duke përfshirë të gjitha miratimet dhe licencat e nevojshme që i garantojnë Huamarrësit dhënien e lejeve të ndërtimit dhe shfrytëzimit apo pronësisë së tokës të nevojshme për kryerjen e projektit;

i) do të shmangë kërkesat ndaj Huamarrësit për të bërë investime të reja ose për të hyrë në ndonjë marrëveshje koncesionare që nuk janë pjesë dhe nuk janë përfshirë në planin e biznesit të Huamarrësit, dhe në veçanti do të shmangë kërkesat ndaj Huamarrësit për të bërë koncesione të reja në lidhje me hidrocentralet e vegjël;

j) do të mbështesë çdo përpjekje të Huamarrësit për të eliminuar tarifat e subvencionuara të energjisë elektrike për konsumatorët buxhetorë dhe jobuxhetore, si dhe për konsumatorët privatë, të përcaktuar në planin e veprimit;

k) do të mbështesë zbatimin prej Huamarrësit të fondit balancues;

l) do të zbatojë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet e Garantuesit në përputhje me traktatin ECSEE, të datës 25 tetor 2005;

m) do të zhvillojë dhe miratojë, përpara datës 31 dhjetor 2006, procedura transparente dhe konkurruese për dhënien e koncesioneve të reja në lidhje me hidrocentralet e vegjël;

n) do të shmangë ndërhyrjen ndaj planit të investimeve të Huamarrësit;

o) do të sigurojë një operator plotësisht funksional të sistemit të transmetimit (OST) nga data 1 korrik 2007;

p) do të mbështesë çdo përpjekje të Huamarrësit për të vënë në jetë, sa herë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, rregullime në nivelin dhe strukturën e tarifave të Huamarrësit për të siguruar që Huamarrësi është në gjendje për të përmbushur detyrimet e veta që rrjedhin nga targetet e planit të veprimit, si dhe për të arritur arkëtimin e kostos së plotë;

q) do të krijojë dhe do të zbatojë një mekanizëm ose procedura për të zvogëluar pasojat e çdo rritjeje në nivelin e tarifave të energjisë elektrike të konsumatorët socialë me vulnerabël;

r) nuk do të amendojë, pezullojë, shfuqizojë, anulojë apo rregullojë kuadrin legjislativ dhe rregullues të zbatueshëm për sektorin energjetik në territorin e Garantuesit, me përjashtim të rasteve kur këto veprime, sipas gjykimit të vetë Bankës janë në përputhje me ato të targetuara në planin e veprimit ose deklaratën e politikave të sektorit energjetik.

Neni 3 Të ndryshme

Seksioni 3.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme parashikohen në funksion të sektorit 10.01 të termave dhe kushteve standarde.

Për Garantuesin:

Ministria e Financave e Republikës së
Shqipërisë
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr.1. Tiranë,
Shqipëri
Në vëmendje të: Ministri i Financave
Fax: +355 4 22 8494

Për Bankën:

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square, London EC2A 2JN, UK
To the attention of: Operational Administration
Unit
Fax: +44 20 7338 6100

Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

Në funksion të seksionit 9.03(b) të termave dhe kushteve standarde dhe në përputhje me seksionin 6.02 të marrëveshjes së huasë, opinioni apo opinionet ligjore në emër të Garantuesit do të jepen nga Ministri i Drejtësisë.

Në dëshmi të sa më sipër, Palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruan këtë Marrëveshje në katër kopje, në Tiranë, Shqipëri, në ditën dhe vitin e përcaktuar më lart.

MARRËVESHJE E HUASË

**PROJEKTI I REHABILITIMIT TË NËNSTACIONEVE TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE
DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Marrëveshje e datës 2005 ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (Huamarrësi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka)

HYRJE

Duke pasur parasysh se Banka është krijuar për financimin e projekteve specifike për tranzicionin e ekonomive të orientuara drejt tregut të hapur, si dhe për të nxitur iniciativat private dhe sipërmarrjet në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore të angazhuara dhe që zbatojnë parimet e demokracisë, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

se Huamarrësi synon të zbatojë projektin e përshkruar në listën 1 ("Projekti") që është disenuar për të ndihmuar Huamarrësin në financimin e zëvendësimit të pajisjeve të vjetruara të tensionit të lartë, si dhe në kontrollin e sistemeve të mbrojtjes në gjashtë nënstacione në Republikën e Shqipërisë;

se Huamarrësi synon të alokojë një shumë të përafërt me katër milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë euro (4 112 000 euro) për financimin e projektit;

se Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

se Republika e Shqipërisë ka marrë një hua (shuma e së cilës i është vënë në dispozicion tashmë Huamarrësit) nga Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar, në shumën e njëzet e shtatë milionë dollarë (27 000 000 USD) për të asistuar në financimin e një pjese të projektit, sipas termave dhe kushteve të parashtruara në një marrëveshje (Marrëveshja e bashkëfinancimit), ku kanë hyrë Huamarrësi dhe Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar;

se Huamarrësi synon të alokojë një shumë të përafërt me katër milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë euro për financimin e projektit;

se, në mbështetje të një marrëveshjeje garancie të datës së përcaktuar këtu ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Marrëveshja e garancisë), Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

se, sikurse është rënë dakord më parë, Banka, ndër të tjerash, do të mundësojë huanë për Huamarrësin për një shumë prej 16 milionë euro (gjashtëmbëdhjetë milionë euro), subjekt i termave dhe kushteve të paraqitura apo referuar kësaj Marrëveshjeje; dhe

atëherë, pjesëmarrësit këtu bien dakord si më poshtë:

Termat dhe kushtet standarde, përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës së datës 1 maj 2006, janë përfshirë në këtë Marrëveshje, si dhe janë bërë të zbatueshme me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur janë pasqyruar plotësisht këtu (këto dispozita do të quhen më tej “Termat dhe kushtet standarde”).

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që të haset në këtë Marrëveshje (duke përfshirë si hyrjen, ashtu dhe Listet), vetëm nëse është thënë me kuptim tjetër, apo ka kuptim tjetër në kontekst, termat e përcaktuara në hyrje kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë aty, termat e përcaktuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë aty, ndërsa termat shtesë të mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Plani i veprimit” do të thotë plani i përgatitur nga KESH dhe i miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.43, të datës 13 janar 2006 “Mbi miratimin e planit të veprimit në lidhje me performancën e sektorit të energjisë për periudhën 2006-2008”, bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje si shtojca A, ripunimet e përvitshme bërë pas kësaj, të pranueshme për Bankën.

“Përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit” do të thotë Ministri i Financave i Huamarrësit, me përjashtim të rasteve të specifikuar në seksionin 2.03(c).

“Rrjedhja kesh e disponueshme për shërbimin e borxhit” do të thotë rrjedhja e keshit nga aktivitetet operuese plus çdo interes të paguar gjatë kësaj periudhe.

“Rrjedhja kesh nga aktivitetet operuese” do të thotë të gjitha rrjedhjet e keshit nga aktivitetet operuese siç përcaktohet nga IFRS. Nëse, për ndonjë arsye, deklaratimet financiare të audituara IFRS nuk janë të disponueshme për ndonjë vit fiskal, rrjedhja kesh nga aktivitetet operuese do të thotë, për një periudhë të tillë, të ardhurat neto të Huamarrësit gjatë kësaj periudhe pas tatimit, plus amortizimin dhe nënçmimin, plus çdo shpenzim jo kesh të kryer plus çdo zbritje gjatë kësaj periudhe (ose, nëse është rasti, minus çdo rritje gjatë kësaj periudhe) në kapitalin funksional.

“Bashkëmenaxhues” do të thotë një njësi e përfshirë në zbatim të programit të asistencës menaxheriale dhe të pranueshme për Bankën.

“Borxh” do të thotë, në lidhje me Huamarrësin, mbi baza të konsoliduara, të gjitha detyrimet e Huamarrësit mbi baza të konsoliduara, të gjitha detyrimet e Huamarrësit të kryera si principale apo dytësore, si dhe të tashme, të ardhshme, faktike apo kontigjence, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar te:

a) çdo shumë e pagueshme prej Huamarrësit sipas qirave apo marrëveshjeve të ngjashme përgjatë periudhave të tyre respektive;

b) çdo kredi e dhënë Huamarrësit prej një furnizuesi mallrash ose si pasojë e një blerjeje me këste apo sipas një marrëveshjeje tjetër të ngjashme; dhe

c) çdo përgjegjësi dhe detyrim ndaj palëve të treta në masën që ato janë garantuar prej Huamarrësit ose që Huamarrësi në një mënyrë ose në një tjetër ka marrë përsipër ose është bërë përgjegjës për pagesën e detyrimeve të tilla ose në masën që ato janë siguruar nga ndonjë barrë mbi pronën e Huamarrësit, pavarësisht nëse Huamarrësi e ka marrë përsipër ose është bërë përgjegjës për pagesën e detyrimeve të tilla.

“Shërbimi i borxhit” do të thotë, për çdo periudhë, shumën e të gjitha pagesave të planifikuara të principalit, interesit dhe tarifave mbi borxhin e Huamarrësit.

“Llogaria e shërbimit të borxhit” do të thotë llogaria e posaçme që përfiton interes e referuar në seksionin 3.08(a).

“Raporti i mbulimit të shërbimit të borxhit” do të thotë raporti i përfituar pas ndarjes së rrjedhjes së keshit e disponueshme për shërbimet e borxhit nga shërbimi i borxhit.

“Sasia rezervë e shërbimit të borxhit” do të thotë, në çdo kohë dhe në lidhje me monedhën e huasë, shumën e principalit, interesit dhe shumat e tjera të planifikuara për t’u bërë të disponueshme dhe të pagueshme Bankës gjatë gjashtëmujorit pasues e shumëzuar me 1.25.

“EBITDA” do të thotë fitimi operativ i Huamarrësit përpara marrjes në konsideratë të interesit, tatimit, nënçmimit dhe amortizimit, duke përjashtuar gjithashtu çdo element të jashtëzakonshëm dhe të veçantë.

“Plani i veprimit të mjedisit”-do të thotë plani i veprimit të mjedisit, bazuar në rekomandimet

mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis që duhet rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës në formë e përmbajtje i pranueshëm nga Banka, duke pasur parasysh mjedisin e lidhur me projektin, siç mund të amendohet herë pas here me miratim paraprak të shkruar nga Banka.

“Çështje mjedisore” do të thotë:

- a) ndotja ose mbrojtja e mjedisit;
- b) dëmi ndaj ose mbrojtja prej tij e shëndetit njerëzor;
- c) shëndeti dhe siguria në vendin e punës; ose
- d) çdo lëshim ose substancë e aftë të shkaktojë dëmtimin e një organizmi të gjallë ose të mjedisit.

“Traktati i Komunitetit të Energjisë të Europës Juglindore” (ECSEE) do të thotë traktati i nënshkruar në datën 25 tetor nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Republika e Kroacisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumania, Republika e Turqisë, Serbisë dhe Malit të Zi, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Kosovës dhe Komuniteti Europian, që parashtron angazhimin dhe procesin e pjesëmarrësve për të përmirësuar sektorin e energjisë së rajonit të Europës Juglindore dhe për të krijuar një treg për energjinë dhe gazin në rajonin e Europës Juglindore, siç mund të amendohen herë pas here.

“Fondi balancues” do të thotë një fond që do të krijohet nga KESH, me qëllim që fitimet që rezultojnë nga kushtet e favorshme hidrologjike të ruhen në këtë fond për të mbuluar koston e importit të energjisë elektrike, në rastet e kushteve jo të mira hidrologjike.

“Vit fiskal” do të thotë periudha 12-mujore që nis në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor.

“IFRS” do të thotë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të lëshuara ose miratuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe të zbatuara në mënyrë konsistente.

“Plani i investimeve” do të thotë një plan investimesh i përgatitur prej Huamarrësit në një formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën:

“Lek” do të thotë monedha e ligjshme në Republikën e Shqipërisë.

“Llogaria lokale e projektit” do të thotë llogaria e posaçme që përfiton interes, e referuar në seksionin 3.08 (b).

“Sasia rezervë lokale e projektit” do të thotë në çdo moment gjatë periudhës së ndërtimit, sasia e kontributit të Huamarrësit për projektin gjatë gjashtëmujorit pasues.

“Programi i asistencës menaxheriale” do të thotë programi i asistencës për menaxherët kryesorë të Huamarrësit dhe OST-së e referuar në seksionin 3.06.

“Raporti operacional” do të thotë një raport operacional, në një formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, që i dërgohet Bankës prej Huamarrësit.

“PMU” do të thotë njësia e menaxhimit të projektit e referuar në seksionin 3.02.

“Deklarata e politikave të sektorit energjetik” do të thotë deklarata e politikave e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Garantuesit më 19 prill 2002, siç mund të amendohet herë pas here me miratimin e Bankës.

“Çështje sociale” do të thotë:

- a) standardet e punës dhe kushtet e punësimit të rregulluara nga ligji i zbatueshëm;
- b) pasojat te njerëzit dhe prej zhvendosjes ose blerjes së tokës;
- c) pasojat te njerëzit lokalë ose grupe të tjera të ndjeshme (vulnerabël);
- d) pasojat mbi objektet e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë këtu edhe artifaktet dhe zonat arkeologjike;
- e) ose konsultimet dhe bërjen publike të tyre, duke përfshirë këtu edhe zemëratën e një pjese të publikut të njoftuar prej Huamarrësit;

“OST” do të thotë operatori i sistemit të transmetimit, që i është referuar seksioni 3.01(f).

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referimi ndaj një neni specifik, seksioni apo liste, (me përjashtim të rasteve që nuk paraqiten në këtë Marrëveshje), do të paraqitet si referencë për atë nen apo seksion specifik apo listë në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Termet kryesorë të huasë

Seksioni 2.01 Shuma dhe monedha

Bazuar në termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje, Banka bie dakord të japë një hua për Huamarrësin në një shumë prej gjashtëmbëdhjetë milionë (16 000 000) euro.

Seksioni 2.02 Terma të tjerë financiarë të huasë:

- a) sasia minimale për tërheqje do të jetë pesëdhjetë mijë euro (50 000 euro);
- b) sasia minimale e parapagesës do të jetë pesë milionë euro (5 000 000 euro);
- c) sasia minimale e anuluar do të jetë tre milionë euro (3 000 000 euro);
- d) data e pagesës së interesit do të jetë 4 prilli dhe 4 tetori i çdo viti;
- e) (1) Huamarrësi do të paguajë huanë në 18 këste të barabarta (apo afërsisht të barabarta), në periudha gjashtëmujore më 4 prill dhe 4 tetor të çdo viti, me datë të parë të pagimit të huasë më 4 prill 2010 dhe datë të fundit të pagimit të huasë më 4 tetor 2018.

2. Pavarësisht, çfarë është paraqitur më lart, në rast se: (i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e huasë para datës së parë të ripagimit të specifikuar në seksionin 2.02(e), dhe (ii) Banka e shtyn datën e fundit të disponueshmërisë së specifikuar në seksionin 2.02(f) më poshtë në një datë e cila bie pas kësaj date ripagimi, ndaj shuma e kësaj tërheqjeje, të bërë në apo pas datës së parë të ripagimit duhet të shpërndahet për ripagim në shuma të barabarta në data të ndryshme të ripagimit të huasë, të cilat janë pas datës së kësaj tërheqjeje (ku Banka rregullon shumat e shpërndara në mënyrën më të mirë të mundshme). Banka herë pas here duhet të njoftojë Huamarrësin për këtë shpërndarje;

f) data e fundit e disponueshmërisë duhet të jetë 31 dhjetor 2009;

g) tarifa e angazhimit do të jetë 0.5% në vit;

h) huaja është subjekt i normave të ndryshueshme të interesit. Pavarësisht çfarë është paraqitur më lart, Huamarrësi mundet, që si një alternativë për pagesën e normës së ndryshueshme të interesit mbi të gjithë apo ndonjë pjesë të huasë në atë moment të papaguar, të zgjedhë të paguajë interesin me një normë fikse interesi mbi këtë pjesë të huasë në përputhje me seksionin 3.04(c) të termave dhe kushteve standarde.

Seksioni 2.03 Tërheqjet

a) Sasia e disponueshme mund të tërhiqet nga një periudhë në tjetrën, në përputhje me parashikimet e bëra në listën 2, për të financuar: (1) shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka bie dakord që këto të realizohen) në përputhje me kostot e arsyeshme të punimeve të kërkuara për projektin, dhe (2) komisionin përmbyllës.

Neni 3

Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01 Angazhime të tjera të miratuara

Përveç angazhimeve të përgjithshme të paraqitura në nenin 4 të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

a) do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të dhënë fondet e nevojshme për përfundimin e projektit;

b) do të miratojë dhe zbatojë planin e veprimit duke mbuluar të gjitha aspektet e operacioneve të tij për periudhën dyvjeçare pasuese përpara datës 31 dhjetor të çdo viti.

c) do të sigurojë arritjen e duhur të targeteve financiare të specifikuara në planin e veprimit dhe në veçanti të sigurojë se targetet në lidhje me humbjet dhe arkëtimet arrihen për çdo tremujor kalendarik në fund të atij tremujori;

d) do të kërkojë kur është e nevojshme dhe në përputhje me procedurat në fuqi të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar, prej autoriteteve rregullatore përkatëse të Garantuesit ristrukturimin e çmimeve për konsumatorët për të arritur nivelin e kostos në shkallë korporate mbi bazën e çdo tremujori dhe në një minimum në përputhje me planin e veprimit në fuqi;

e) do të zbatojë, mbi bazën e kontratës së asistencës menaxheriale, programin e asistencës menaxheriale mbi termat e referencës dhe në një mënyrë të kënaqshme për Bankën përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit;

f) do të ndajë asetet e operatorit të ri të transmetimit të energjisë (OST) nga ato të Huamarrësit dhe të përfundojë ndarjen financiare ndërmjet Huamarrësit dhe OST-së nga fundi i vitit 2007;

g) do të zhvillojë një plan biznesi për operatorin e ri të transmetimit të energjisë OST përpara datës 31 dhjetor 2006; dhe

h) do të zbatojë dhe përmbush kërkesat dhe detyrimet e traktatit të ECSEE.

Seksioni 3.02 Njësia e menaxhimit të projektit

a) Huamarrësi do të krijojë një njësi të zbatimit të projektit ("PMU") me të gjitha burimet e mjaftueshme, si dhe një personel të kualifikuar, duke përfshirë ndërmjet të tjerëve edhe një punonjës financiar dhe një punonjës prokurimi, me qëllim që të koordinohen, menaxhohen, monitorohen dhe vlerësohen të gjitha aspektet e zbatimit të projektit, nën termat e referencës të pranueshme nga Banka, duke përfshirë dhe prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të projektit.

b) Huamarrësi, nën termat e referencës të pranuar nga Banka, do të mbajë dhe do të krijojë mundësinë e operimit të konsulentëve për të ndihmuar PMU-në gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit me synim:

1. rishikimin dhe finalizimin e çështjeve të prokurimit, duke përfshirë edhe dokumentet e tenderimit;

2. procesin e tenderimit;

3. raportimin në kohë dhe me saktësi;

4. monitorimin dhe rifreskimin e sasisë së rezervës së projektit lokal dhe llogarinë lokale të projektit; dhe

5. mbikëqyrjen e zbatimit të përgjithshëm të projektit.

Seksioni 3.03 Prokurimet

Për qëllime të seksionit 4.03 të termave dhe kushteve standarde, masa të tilla duhen zbatuar, me përjashtim të rasteve kur Banka nuk është dakord, të cilat do të drejtojnë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga procedurat e huasë.

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet do të prokurohen me tender të hapur në përputhje me politikat dhe rregullat e prokurimit të BERZH-it.

b) Për qëllime të seksionit 3.03(a), procedurat për tenderimin e hapur, tenderimin me përzgjedhje, tenderimin e drejtpërdrejtë, si dhe për blerjet e standardet për tenderimin mbi bazën e konkurrencës brenda vendit, janë paraqitur në kapitullin 3 të rregullave të prokurimit të BERZH-it.

c) Të gjithë kontratat do të jenë subjekt i rishikimit të procedurave të paraqitura në aneksin 1 të rregullave të prokurimit të BERZH. Kontratat për mallra, punime dhe shërbime që vlerësohen të kushtojnë me tepër se 200,000 euro ose ekuivalenten e kësaj shume në një monedhë tjetër, do të jenë subjekt i rishikimit paraprak të BERZH-it.

Seksioni 3.04 Angazhimet lidhur me mjedisin

Pa kufizuar përgjithësimin e seksionit 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, si dhe seksionit 3.04(c) më lart, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi:

a) me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe në planin e veprimit të mjedisit, do të realizojë projektin në përputhje me rregullat dhe standardet e mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë që ndryshojnë hera-herës, sipas juridiksionit të vendit ku ndeshet projekti, si dhe me standardet ekzistuese të BE-së mbi mjedisin, shëndetin dhe sigurinë nëse janë të zbatueshme dhe nëse jo me standardet mjedisore në udhëzuesit e grupit të Bankës Botërore;

b) do t'i përmbahet të gjitha ligjeve të zbatueshme, si dhe standardeve mbi punësimin, në veçanti ato të lidhura me punësimin e fëmijëve dhe të të rinjve, diskriminimin në punë, si dhe punën e detyruar. Ligjet dhe standardet e aplikueshme përfshijnë: (i) angazhimet përkatëse lidhur me Organizatën Ndërkombëtare të Punës, dhe (ii) ligjin vendas; dhe

c) do të zbatojë në mënyrë të kujdesshme dhe do të përkrahë planin e veprimit të mjedisit.

Seksioni 3.05 Konsulentët

a) Me qëllim që të mbështetet zbatimi i projektit, Huamarrësi duhet që, me përjashtim të rasteve kur Banka nuk është dakord, të punësojë apo të krijojë mundësi punësimi për konsulentë, duke përfshirë, por duke u kufizuar me kaq, një konsulent monitorimi mjedisor për projektin, kualifikimi, eksperiencia dhe termat e referencës së të cilëve janë të pranueshme nga Banka. Këta konsulentë do të ndihmojnë PMU-në me prokurimet, mbikëqyrjen e zbatimit, trajnimin dhe transferimin e *know-how*.

b) Huamarrësi duhet të paraqesë, pa tarifë, përpara çdo konsulenti të përfshirë në mbështetjen e elementeve të projektit apo në operacionet e Huamarrësit, të gjitha lehtësitat e nevojshme, si dhe mbështetjen e nevojshme për të realizuar funksionet e tyre, duke përfshirë këtu të gjitha dokumentet, materialet, si dhe çdo informacion tjetër që mund të lidhet me punën e tyre.

Seksioni 3.06 Programi i asistencës menaxheriale

Huamarrësi do të themelojë dhe mbajë programin e asistencës menaxheriale, me terma dhe kushte të pranueshme për Bankën, sipas të cilit Huamarrësi do të kontraktojë një shoqëri utilitetesh të huaj që do t'i sigurojë një ekip bashkëmenaxherësh për të kryer detyra të caktuara me qëllim përmirësimin e të gjitha aspekteve të operacioneve të Huamarrësit.

Seksioni 3.07 Frekuenca e raportimit dhe kërkesat për paraqitjen e dokumenteve

a) Deri në pagesën e plotë apo anulimin e shumës së huasë, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës raporte vjetore lidhur me çështjet mjedisore të projektit referuar seksionit 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, më apo përpara datës 31 mars të çdo viti. Raporte të tilla do të përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me shëndetin e punëtorëve, si dhe sigurinë e tyre lidhur me projektin, sikurse dhe elemente të tillë specifike, si:

i) informacion mbi respektimin nga ana e Huamarrësit të rregullave dhe standardeve lidhur me mjedisin, specifikuar në seksionin 3.04, duke përfshirë dhe statusin e çfarëdo leje mjedisore të kërkuar për projektin, rezultatet e cilitdo inspektim të kryer nga autoritetet e mjedisit, ndonjë shkelje të rregullave dhe standardeve të tilla të mjedisit, si dhe masat përmirësuese të ndërmarra apo dhe gjoba të vëna në raste shkeljesh;

ii) informacion lidhur me zbatimin e planit të veprimit të mjedisit, duke përfshirë dhe ndonjë ndryshim të propozuar apo devijim në veprime, kalendar apo kosto;

iii) një përmbledhje të çfarëdo shënimi material, raporteve apo komunikimeve lidhur me çështjet e mjedisit apo ato sociale, të paraqitura nga Huamarrësi përpara cilitdo autoriteti rregullator;

iv) informacion lidhur me shëndetin dhe sigurinë e projektit, duke përfshirë dhe shkallën e aksidenteve apo çdo iniciativë të lidhur me shëndetin dhe çështjet e sigurisë që janë zbatuar apo planifikuar nga Huamarrësi;

v) një përmbledhje të ndryshmeve në ligjet e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë, që mund të kenë një ndikim material mbi projektin;

vi) kopje të informacionit mbi çështjet mjedisore dhe ato sociale të paraqitura në mënyrë periodike nga Huamarrësi pranë partnerëve apo në publik.

b) Raportet periodike të projektit referuar seksionit 4.04(a)(iv) të termave dhe kushteve standarde duhet të paraqiten çdo tremujor, brenda 30 ditëve të periudhës së raportuar, kjo deri në përfundim të projektit. Këto raporte do të përmbajnë elementet specifike si më poshtë:

i) informacion të përgjithshëm si më poshtë:

1. progresin fizik të përmbushur në zbatim të projektit deri në datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

2. vështirësitë aktuale apo të pritshme sikurse dhe vonesat në zbatim të projektit, si dhe ndikimin e tyre në kalendarin e zbatimit, si dhe hapat konkretë të marra apo të planifikuara për të kaluar vështirësitë dhe shmangur vonesat;

3. ndryshimi i mundshëm i datës së përfundimit të projektit;

4. ndryshime në personelin kryesor të PMU-së, konsulentëve apo kontraktorëve;

5. arsyet që mund të ndikojnë në koston e projektit; dhe

6. ndonjë zhvillim apo aktivitet që ka të ngjarë të ndikojë në aspektin ekonomik të cilësdo pjesë të projektit;

ii) një diagramë e tipit *bar-chart*, bazuar në kalendarin e zbatimit të projektit, duke treguar progresin në çdo pjesë të projektit, si dhe duke përfshirë një grafik të shpenzimeve të planifikuara, si dhe atyre aktuale;

iii) raportet financiare duhet të paraqesin detaje të shpenzimeve të realizuara nën secilën pjesë të projektit, si dhe tërheqjet nga huaja, së bashku me një deklaratë, ku tregohen:

1. llogaritjet origjinale të kostos;

2. kostot e rishikuara, nëse ka të tilla, si dhe arsyet për këto ndryshime;

3. llogaritjet origjinale të shpenzimeve deri në datën e raportimit;

4. arsyet për devijimet e pikës (3) më lart nga shpenzimet aktuale; dhe

5. shpenzimet e llogaritura për tremujorët e mbetur të vitit; dhe

iv) një dokument i shkurtër mbi statusin e përputhshmërisë me secilën nga angazhimet e marra në marrëveshjen e huasë.

c) Menjëherë, me ndodhjen e ndonjë incidenti apo aksidenti të lidhur me projektin që ka të ngjarë të ketë dhe një efekt jo të favorshëm material mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë, Huamarrësi

duhet të njoftojë Bankën me anë të njoftimit me faks apo telex, duke specifikuar natyrën e një incidenti apo aksidenti të tillë, si dhe ndonjë hap të ndërmarrë nga Huamarrësi për rregullimin e situatës. Pa kufizuar përgjithësinë e kësaj, një incident ose një aksident ka të ngjarë që të shkaktojë një efekt material mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë, nëse çdo ligj i aplikueshëm kërkon njoftimin e një incidenti apo aksidenti të tillë pranë cilitdo autoriteti shtetëror, incidente apo aksidente të tilla përfshijnë fatalitetet apo plagosje serioze që kërkojnë shtrim në spital, apo nëse një incident apo aksident i tillë është bërë publik si nëpërmjet medias, apo mjeteve të tjera.

Seksioni 3.08 Llogaritë e projektit

a) Huamarrësi, për qëllime të projektit, ka të drejtë të hapë dhe të mbajë deri në përfundimin e plotë dhe të çdo detyrimi që ai ka nën këtë Marrëveshje, një llogari të posaçme depozite në monedhën e huasë (Llogaria e shërbimit të huasë) në një bankë tregtare me terma dhe me kushte të pranueshme për Bankën, të cilat të përfshijnë edhe mbrojtje të përshtatshme ndaj çdo të drejte kompensimi, sekuestroje apo konfiskimi dhe do të autorizojë këtë bankë tregtare që t'i lejojë Bankës akses të drejtpërdrejtë në çdo kohë në të gjitha të dhënat dhe deklaratat në lidhje me llogarinë e shërbimit të huasë. Pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të mbajë në llogarinë e shërbimit të huasë një balancë minimale që përputhet me shumën e rezervës së shërbimit të huasë. Huamarrësi mund të tërheqë shuma nga llogaria e shërbimit të huasë vetëm për qëllime të kryerjes së pagesave nën marrëveshjen e huasë.

b) Huamarrësi, për qëllime të projektit, deri në përfundimin e punimeve ndërtimore të projektit, ka të drejtë të hapë dhe të mbajë një llogari të posaçme depozite (Llogaria lokale e projektit) në një bankë tregtare me terma dhe me kushte të pranueshme për Bankën, të cilat të përfshijnë edhe mbrojtje të përshtatshme ndaj çdo të drejte kompensimi, sekuestroje apo konfiskimi, dhe do të autorizojë këtë bankë tregtare që t'i lejojë Bankës akses të drejtpërdrejtë në çdo kohë në të gjitha të dhënat dhe deklaratat në lidhje me llogarinë lokale të projektit. Pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të mbajë në llogarinë lokale të projektit një balancë minimale që përputhet me shumën e rezervës së shërbimit të huasë.

Neni 4

Dispozita financiare dhe operacionale

Seksioni 4.01 Të dhënat dhe raportet financiare

a) Huamarrësi do të mbajë, në përputhje me departamentet apo agjencitë përgjegjëse të tij për realizimin e projektit, të gjitha procedurat, të dhënat, si dhe llogaritë për të reflektuar, në përputhje me standardet e pranura dhe të zbatuara ndërkombëtare IFRS, operacionet, burimet dhe shpenzimet e lidhura me projektin, si dhe të monitorojë dhe reflektojë progresin e projektit (duke përfshirë kostot e tij, si dhe përfitimet që krijohen prej tij).

b) Huamarrësi:

i) do të ketë të dhënat dhe llogaritë në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni (duke përfshirë bilancin, deklaratën e të ardhurave dhe deklaratën e rrjedhjes së keshit dhe shënimet përkatëse), duke përfshirë ato që kanë lidhje me llogarinë e shërbimit të borxhit dhe llogarinë lokale të projektit dhe të dhënat, llogaritë dhe deklaratat financiare të pjesëve përbërëse të tij (*subsidiaries*), për çdo vit fiskal të audituar, në përputhje me parimet dhe standardet IFRS, realizuar nga revizorë të pavarur të pranuar nga Banka, anëtarë të një organizmi kontabiliteti profesional që është pjesë e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC);

ii) do të paraqesë pranë Bankës, sapo të ketë në dispozicion, por në çfarëdo rasti jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo muaji të raportit operacional, raport, i cili do të përfshijë, *inter alia*, raportimin specifik mbi performancën *vis-à-vis* me planin e veprimit në lidhje me muajin që sapo u mbyll, të përgatitur nga ose në bashkëpunim me njësinë e kontraktuar sipas programit të asistencës menaxheriale, në detaje të mjaftueshme që i mundësojnë Bankës të përcaktojë nëse targetet tremujore që përfshihen në planin e veprimit janë arritur apo jo;

c) do të paraqesë pranë Bankës, sapo të ketë në dispozicion, por në çfarëdo rasti jo më vonë se gjashtë muaj nga mbarimi i çdo viti fiskal; (A) kopje të vërtetuara të deklaratave financiare për këtë vit fiskal të audituar (duke përfshirë deklarata financiare të veçanta për operatorin e transmetimit të

energjisë subsidar i tij, sapo kjo njësi të bëhet plotësisht operative); (B) raportin e një auditimi të tillë nga revizorët e caktuar për këtë qëllim, në detaje të tilla që t'i përgjigjen kërkesave të arsyeshme të Bankës; (C) një deklaratë të të gjitha transaksioneve financiare ndërmjet Huamarrësit dhe secilit prej subsidarëve dhe afiliatëve të vet; (D) një deklaratë të raportit të mbulimit të shërbimit të borxhit të specifikuar në seksionin 4.03(a) më poshtë është mbajtur, (E) një deklaratë se raporti borxh EBITDA e specifikuar në seksionin 4.03(b) është mbajtur; (F) planin e investimeve për tre vitet pasuese; dhe (G) një raport të auditorëve që vërteton se Huamarrësi është në përmbushje të dispozitave financiare që përcaktohen në seksionin 4.03 nga fundi i vitit fiskal relevant ose, sipas rastit, duke detajuar çdo mospërmbushje; dhe

iv) do të paraqesë pranë Bankës informacione të tjera lidhur me të dhënat dhe llogaritë, sikurse dhe auditin, sa herë që kjo të kërkohej nga Banka.

Seksioni 4.02 Dispozita financiare negative

a) Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, nuk do të ndërmarrë ndonjë prej veprimeve të mëposhtme (dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme):

1. të hyjë në ndonjë marrëveshje apo kontratë për të garantuar ose në njëfarë mënyre ose nën ndonjë kusht të caktuar të detyrohet plotësisht ose pjesërisht për ndonjë detyrim financiar të një personi tjetër, duke përfshirë edhe subsidiaret ose afiliatet;

2. të hyjë në ndonjë transaksion me cilindo person, me përjashtim të rasteve në rrjedhën normale të biznesit, me terma normalë tregtarë mbi bazën e dispozitave të papërcaktuara, ose të krijojë një agjenci ekskluzivisht për blerje ose shitje, ose të hyjë në ndonjë transaksion në të cilën Huamarrësi mund të paguajë më tepër sesa çmimi normal tregtar *might pay more than* për çfarëdolloj blerje ose të përfitojë më pak sesa çmimi normal tregtar (duke përjashtuar zbritjen normale tregtare) për prodhimet dhe shërbimet e tij;

3. të hyjë në ndonjë partneritet, me ndarje fitimesh apo marrëveshje me honorare ose ndonjë marrëveshje tjetër të ngjashme, sipas së cilës të ardhurat apo fitimet e Huamarrësit duhet të ndahen me cilindo person tjetër;

4. (në mënyrë të vullnetshme ose të pavullnetshme) të bëjë ndonjë parapagim, riblerje ose shlyerje të përshpejtuar të ndonjë borxhi ose të bëjë ndonjë parapagim borxhi në përputhje me një dispozitë të një marrëveshjeje ose shënimi, i cili në mënyrë direkte ose indirekte garanton përshpejtimin e ripagimit në kohë ose në sasi, me përjashtim të rasteve të tilla, nëse Banka e kërkon këtë, Huamarrësi njëkohësisht bën një parapagim proporcional me të për principalin e mbetur të huasë ende të pashlyer në përputhje me dispozitat e seksionit 3.07 të termave dhe kushteve standarde (me kusht që çdo sasi e parapagimit të mos jetë subjekt i kërkesave për sasinë minimale të parapagimit); ose

5. të marrë përsipër ose të lejojë një shkrirje, konsolidimin ose riorganizimin, në kushtet kur Banka nuk do të vonojë ose mos pranojë në mënyrë të paarsyeshme miratimin e vet në lidhje me veprimin e kërkuar në mbështetje të deklaratës së politikave të sektorit energjetik.

b) Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur informon Bankën të paktën 30 ditë më parë, nuk do të ndërmarrë ndonjë prej veprimeve të mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1. të hyjë në ndonjë kontratë menaxhimi ose marrëveshje të ngjashme, sipas së cilës biznesi dhe operacionet e saj menaxhohen nga një person tjetër, duke përfshirë çdo subsidiare ose afiliate (përveç kontratave të lidhura në lidhje me programin e asistencës menaxheriale që janë të pranueshme për Bankën); ose

2. të formojë një subsidiar, ose të bëjë, ose të lejojë të ekzistojnë hua ose parapagime, ose depozitime, (me përjashtim të depozitimeve të kryera gjatë zhvillimit të biznesit normal në banka me reputacion) me persona të tjerë ose investime për një person, duke përfshirë çdo subsidiare ose afiliate; megjithatë, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi është i lirë të investojë në aksione me vlerë tregu dhe afatshkurtra me qëllimin e vetëm për të vënë në punë burimet e papërdorura të Huamarrësit.

c) Huamarrësi nuk do të hyjë pa miratimin paraprak të Bankës (ky miratim nuk mund të mos jepet në mënyrë të paarsyeshme) me një marrëveshje afatgjatë të blerjes së energjisë elektrike, e cila mund të ndikonte në vlefshmërinë kredimarrëse të Huamarrësit.

Seksioni 4.03. Dispozita të tjera financiare

Pa kufizuar përgjithësimin e seksionit 4.02, Huamarrësi, në çdo kohë:

- a) do të mbajë një raport të mbulimit të shërbimit të borxhit të paktën 1.25:1;
- b) do të mbajë një raport të borxhit me EBITDA jo më të lartë se 5.5:1.

Seksioni 4.04 Kryerja e operacioneve të biznesit

Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

a) do të zhvillojë biznesin dhe operacionet e veta në përputhje me standardet dhe praktikën e shëndosha ndërkombëtare administrative, financiare, inxhinierike dhe të tjera, si dhe me vëmendjen e duhur ndaj çdo politike kryesore të veprimtarisë së vet;

b) do të marrë në mënyrë të menjëhershme çdo veprim brenda mundësive të veta për të mbrojtur ekzistencën e vet juridike, për të vazhduar operacionet e veta, si dhe për të përfituar, ruajtur dhe rinovuar të gjitha të drejtat, pronat, pushtetin, privilegjet dhe francaiset e nevojshme për zhvillimin e biznesit, duke përfshirë dhe kryerjen e projektit.

c) nuk do të shesë ose heqë dorë në mënyrë tjetër nga ndonjë prej asetëve të veta që janë të domosdoshme për kryerjen efiçente të operacioneve të veta ose që mund të paragjykojë mundësinë e tij për të performuar në mënyrë të kënaqshme cilindo prej detyrimeve që ka në këtë Marrëveshje;

d) do të njoftojë në mënyrë të menjëhershme Bankën për çdo propozim për të amenduar, pezulluar ose shfuqizuar ndonjë dispozitë të legjislacionit dhe do t'i ofrojë Bankës një mundësi për të komentuar mbi këto propozime përpara se të ndërmarret ndonjë veprim në lidhje me to;

e) do të sigurojë pranë siguruesve të përgjegjshëm ose do të ndërmarret veprime të tjera të kënaqshme për Bankën në lidhje me sigurimin ndaj rreziqeve të dëmeve ose humbjeve, ose detyrimeve në sasi të tilla që janë në përputhje me praktikën përkatëse; dhe

f) në çdo kohë, do të operojë dhe mirëmbajë uzinat, facilitetet, pajisjet dhe çdo pronë tjetër në kushte të mira pune dhe, sapo të dalë nevoja, do të kryejë të gjitha riparimet dhe rinovimet e nevojshme në përputhje me praktikën e shëndosha financiare dhe.

Neni 5

Pezullimi, përshpejtimi

Seksioni 5.01 Ndërprerja

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 7.01.(a) (XVII) të termave dhe kushteve standarde:

a) kuadri legjislativ dhe rregullues i zbatueshëm duhet të jetë i amenduar, i pezulluar, i shfuqizuar, i anuluar apo rregulluar, me përjashtim të rasteve kur veprimet, sipas gjykimit të vetë Bankës janë në përputhje me ato të targetuara në planin e veprimit ose deklaratën e politikave të sektorit energjetik;

b) Huamarrësi do të ketë marrë të gjitha masat e referuara në seksionin 4.02(b) që mund të ndikojnë materialisht dhe të mos favorizojnë operacionet apo kushtet financiare të Huamarrësit, apo aftësinë e tij për të realizuar projektin apo për të përmbushur një nga detyrimet e tij të ndërmarra nën marrëveshjen e huasë;

c) kontrolli i Huamarrësit do t'i jetë transferuar një palë tjetër Garantuese; ose

d) e drejta e Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat e siguruar nën marrëveshjen e bashkëfinancimit do të pezullohet, anulohet apo ndërpritet, e tëra apo pjesërisht, me përputhje me termat e marrëveshjes relevante; megjithatë duhet pasur parasysh se kushtet e këtij paragrafi nuk do të gjejnë zbatim nëse Huamarrësi, me pëlqim të Bankës krijon mundësinë e vënies në dispozicion të fondeve të mjaftueshme për realizimin e projektit, këto nëpërmjet burimeve të tjera nga Huamarrësi, në përputhje me termat dhe kushte mbi detyrimet që ka Huamarrësi nën këtë Marrëveshje.

Seksioni 5.02 Përshpejtimi i maturitetit

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 7.06 (f) të termave dhe kushteve standarde:

a) çdo ngjarje të specifikuar në seksionin 5.01;

b) çdo ngjarje që ka ndodhur dhe vazhdon në lidhje me çdo hua tjetër të dhënë Huamarrësit nga ana e Bankës;

c) çdo ngjarje që ka ndodhur dhe vazhdon në lidhje me huanë e dhënë në zbatim të

Marrëveshjes së bashkëfinancimit,
për tridhjetë ditë pas njoftimit të dhënë nga Banka për.

Neni 6 **Hyrja në fuqi**

Seksioni 6.01 Kushtet e kërkuara për hyrjen në fuqi

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 9.02 (c) të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për vënien në efikasitet të kësaj Marrëveshjeje.

a) Marrëveshja e bashkëfinancimit është lidhur dhe është funksionale dhe të gjitha kushtet për hyrjen e saj në fuqi apo të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqjen sipas saj janë përmbushur me përjashtim të dispozitës për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

b) Marrëveshja e garancisë është ratifikuar nga Parlamenti i Garantuesit.

c) Plani i veprimit është miratuar dhe me fuqi të plotë dhe është paraqitur materialisht në formën e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

d) Një kontratë asistence menaxheriale, që vë në jetë programin e asistencës menaxheriale, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën është lidhur.

e) PMU-ja është ngritur në një mënyrë të kënaqshme për Bankën.

f) Huamarrësi, në një mënyrë të kënaqshme për Bankën, ka përzgjedhur dhe ka caktuar një konsulent menaxhimi për projektin për të asistuar PMU-në me zbatimin e përgjithshëm të projektit deri në përfundimin e plotë të tij.

g) Huamarrësi i ka siguruar Bankës llogaritë e audituara IFRS për vitin financiar që është mbyllur në datën 31 dhjetor 2005.

h) Afatet e zbatimit të projektit dhe strategjia kontraktuese është miratuar nga Banka.

i) Deklarata e politikave të sektorit energjetik është plotësisht në fuqi dhe prodhon pasoja.

j) Fondi balancues është operacional.

k) Llogaria lokale e projektit dhe llogaria e shërbimit të borxhit janë hapur në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën dhe

l) Garantuesi ka konfirmuar afatet për zërat buxhetore dhe jobuxhetore të Huamarrësit në përputhje me planin e veprimit.

Seksioni 6.02 Opinionet ligjore

a) Për qëllime të seksionit 9.03 (a) të termave të kushteve standarde, opinionin apo opinionet ligjore do të jepen në emër të Huamarrësit nga drejtori i departamentit juridik të Huamarrësit.

b) Për qëllime të seksionit 9.03(b) të termave dhe kushteve standarde, opinionin apo opinionet ligjore do të jepen në emër të garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03 Përfundimi për shkak të dështimit për të hyrë në fuqi

Dita e 180-të pas nënshkruesit të kësaj Marrëveshjeje, është specifikuar për qëllime të seksionit 9.04 të termave të kushteve standarde.

Neni 7 **Të ndryshme**

Seksioni 7.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare

Blloku “Vasil Shanto”

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendjen të: Drejtorit të Përgjithshëm

Fax (355) (4) 232 046

Për Bankën:

Banka Europiane për Rindërtimin dhe Zhvillim

One Exchange Square

London EC2A 2 JN, UK

Në vëmendjen të: Njesisë administrative të operacioneve
Fax: + 44-20-7338-6100

Në prani të Palëve, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kjo Marrëveshje nënshkruhet në (katër) kopje në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e shkruar në krye të Marrëveshjes.

LISTA 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është që të ndihmojë Huamarrësin e zëvendësimin e pajisjeve të vjetruara të tensionit të lartë, si dhe të sistemet e kontrollit dhe monitorimit në gjashtë nënstacione transmetimi, me synimin për të zgjidhur jetëgjatësinë dhe për të përmirësuar cilësinë, qëndrueshmërinë, sigurinë dhe efikasitetin e sistemit bazë të transmetimit të energjisë. Projekti do të shërbejë, gjithashtu për të lehtësuar zbatimin e projektit, fuqizuar OST-në dhe ndihmuar rajonin për të arritur një integritet më të madh me BE-në siç është parashikuar në Traktatin ECSEE që do të çonte në një treg unik të elektricitetit.

2. Projekti konsiston në zëvendësimin e pajisjeve të tensionit të lartë në gjashtë nënstacione transmetimi, si dhe instalimin e sistemeve të kontrolluara dhe monitorimit në gjashtë nënstacione transmetimi, i ndarë në pjesët e mëposhtme dhe është subjekt i modifikimeve të mëparshme, për të cilat mund të bien dakord Banka me Huamarrësin kohë pas kohe.

Pjesët e projektit	Llogaritja e kostos (në milionë euro neto pa taksat dhe tatimet)
Pjesa A: Pajisjet e tensionit të lartë dhe sistemet e kontrollit dhe monitorimit (CMS) për gjashtë nënstacione	
Pjesa A-1: Pajisje për nënstacionet: Elbasan 1, Fier, Tirana 1 dhe një sistem MS për nënstacionin e Fierit (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar).	22,54
Pjesa A-2: Sistem MS për nënstacionet: HAP Fierzë, Komani dhe Vau i Dejës si dhe pajisje për nënstacionin HPP Fierzë	6,98
Pjesa A-3: Pajisje dhe sistem CMS për nënstacionet: Burreli dhe Elbasan 2.	9.11
Pjesa B:	
Pjesa B-1: Operimi i PMU-së për të zbatuar pjesët A-1 deri tek A-3 më sipër, duke përfshirë mbështetjen për prokurimin, mbikëqyrjen e zbatimit, trajnimin dhe transferimin e <i>know-how</i> (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar).	0,8
Pjesa B-2: Fuqizimi i OST-së (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar).	0,8
Pjesa B-3: Studimi për çmimet e elektricitetit (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar).	0,24
Pjesa B-4: Përmirësimi i aktiviteteve të prokurimit për importin e elektricitetit (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar)	0,08

Shënim. Llogaria e kostos për pjesën A-1 dhe pjesën B janë konvertuar nga USD në eur duke përdorur në kurs këmbimi USD/EUR 1.23:1.

3. Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor 2009.

LISTA 2

KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëngjitur kësaj liste paraqet kategoritë, shumën e huasë së shpërndarë për secilën kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar në çdo kategori.

SHTOJÇË E LISTËS 2

Kategoritë	Sasia e huasë së shpërndarë në monedhën e huasë	Përqindjet e shpenzimeve për t'u financuar
1. Punimet dhe shërbimet në pjesën A2	6,920,000	100% e vlerës së kontratës, subjekt i tenderimit ndërkombëtar
2. Punimet dhe shërbimet në pjesën A3	8,920,000	100% e vlerës së kontratës, subjekt i tenderimit ndërkombëtar
3. Komisioni përmbyllës	160,000	100% e komisionit përmbyllës
Totali	16,000,000	

LIGJ
Nr.9660, datë 18.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR PJESEMARRJE NË FINANCIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I URËS SË BUNËS, SHKODËR””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për pjesëmarrje në financimin e projektit “Ndërtimi i Urës së Bunës, Shkodër””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5173, datë 28.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE KREDIE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR PJESEMARRJEN NË FINANCIMIN E PROJEKTIT
TË NDËRTIMIT TË URËS SË BUNËS

Kjo Marrëveshje nënshkruhet më __/__/1427 H, e cila i përkon __/__/2006G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu e tutje i referuar si “Kredimarrës”) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (këtu e tutje referuar si “Banka”).

Meqenëse:

A) Kredimarrësi i ka kërkuar Bankës të ndihmojë për mbulimin e kostos së financimit të projektit të Urës së Bunës (këtu e tutje të referuar si “Projekti”) sipas përshkrimit në tabelën I të kësaj

Marrëveshjeje, duke i siguruar kredinë e dhënë më poshtë;

B) një nga qëllimet e Bankës është që të ndihmojë vendet e veta anëtare duke livruar kredi për financime të projekteve dhe programeve të rëndësishme;

C) projekti konsiderohet të jetë teknikisht i bazuar, gjithashtu i përligjur nga pikëpamja ekonomike dhe shoqërore;

D) Banka ka rënë dakord, mbështetur edhe në sa më sipër, t'i japë Kredimarrësit kredinë bazuar në termat dhe kushtet e paraqitura më poshtë;

për këto arsye, Palët janë marrë vesh për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizimet, kushtet e përgjithshme

Seksioni 1.01 Përkufizimet. Kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur nga konteksti rezulton ndryshe, përkufizimet e dhëna në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet e caktuara të mëposhtme:

a) “Disbursim” do të thotë tërheqje e shumës së kredisë.

b) “Procedurë e disbursimit” do të thotë procedurë e disbursimit të Bankës.

c) “Datë e vlefshme” do të thotë data në të cilën Marrëveshja deklarohet e vlefshme nga Banka dhe i komunikohet si e tillë Kredimarrësit.

d) “Agjencia zbatuese” do të thotë Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPRR), Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve e Republikës së Shqipërisë që është institucioni zbatues përgjegjës për realizimin, drejtimin dhe kontrollin e projektit, ose cilido institucion tjetër për të cilin bihet dakord nga Kredimarrësi dhe nga Banka.

e) “Kushte të përgjithshme” do të thotë kushtet e përgjithshme të zbatueshme për kredi dhe marrëveshje garantuese të Bankës që i përkasin datës 8.11.1976.

f) “Dinari islamik/DI”, siç përkufizohet në nenin 4(1)(a) të Marrëveshjes themeluese të Bankës, është njësi për llogaritë e Bankës. Një DI është i barabartë me një të drejtë të veçantë të përfaqësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

g) “Shumë e kredisë” do të thotë shuma për të cilën Banka ka rënë dakord t’ia japë Kredimarrësit në mënyrën e përcaktuar në seksionin 2.01 të kësaj Marrëveshjeje.

h) “Shuma themelore” do të thotë shuma në total e kredisë, aktualisht e tërhequr nga Kredimarrësi në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

i) “Udhëzime të prokurimit” do të thotë udhëzimet për prokurim të mallrave dhe shërbimeve të financuara nga Banka.

j) “Projekti” dhe referime në “pjesë” të tij do të thotë projekti dhe pjesë të tij, ashtu siç janë përshkruar në tabelën I të kësaj Marrëveshjeje.

k) “Tarifë e shërbimit” do të thotë tarifa që i paguhet Bankës nga Kredimarrësi, ashtu siç përcaktohet në seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Kushte të përgjithshme. Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha dispozitat e kushteve të përgjithshme si njëloj të vlefshme dhe efektive, ashtu siç paraqiten në vijim.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01 Shuma e kredisë. Banka bie dakord t’i japë Kredimarrësit kredi nga burimet e veta të zakonshme, në një shumë që nuk tejkalon barasvlerën e DI 6,000,000 (gjashtë milionë dinarë islamikë), afërsisht ekuivalenti i USD 8,570,000 (tetë milionë e pesëqind e shtatë dhjetë mijë dollarë amerikanë) vetëm sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.

Seksioni 2.02 Përveç rastit kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, kontratat për mallra dhe shërbime që do të financohen nga Marrëveshja e kredisë, do të prokurohen me anë të procedurave në përputhje me udhëzuesit e prokurimit të Bankës. Për këtë arsye, Kredimarrësi do t’u përmbahet rregullave të Organizatës së Konferencës Islamike lidhur me bojkotin ndaj shtetit të Izraelit.

Neni 3

Tërheqja dhe përdorimi i shumës së kredisë

Seksioni 3.01 Tërheqja. Shuma e kredisë do të tërhiqet nga Kredimarrësi sipas tabelës III dhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, kushteve të përgjithshme dhe procedurës së disbursimit, për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, për shpenzimet e bëra lidhur me koston e pranueshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për projektin, për të cilin është rënë dakord sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Data për kërkimin e disbursimit të parë. Nëse brenda 180 ditëve nga data e vlefshmërisë, ose çdo datë tjetër e mëvonshme siç do të bihet dakord ndërmjet Kredimarrësit dhe Bankës, Kredimarrësi nuk i paraqet Bankës një kërkesë për të bërë disbursimin e parë, Banka ka të drejtë të pushojë këtë Marrëveshje në bazë të njoftimit përkatës drejtuar Kredimarrësit.

Seksioni 3.03 Data e përfundimit të disbursimit. 31/12/2009, ose një datë mëvonshme për të cilën do të bihet dakord ndërmjet Kredimarrësit dhe Bankës, është data përfundimtare e tërheqjes nga shuma e kredisë për qëllime të seksionit 6.03(c) të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 3.04 Përdorimi i shumës së kredisë. Të gjitha shumat e tërhequra nga Kredimarrësi do të përdoren vetëm për qëllime të projektit të financuar nga Banka.

Neni 4

Zhvleftësimi, tarifa e shërbimit dhe vendet e pagesave

Seksioni 4.01 Zhvleftësimi. Kredimarrësi do të ripagujë shumën themelore në 25 (njëzet e pesë) vjet, duke përfshirë një periudhë shtyrje afati 7-vjeçare, e cila fillon nga data e kësaj Marrëveshjeje, në 36 (e gjashtë) këste të barabarta dhe të pandërprera gjashtëmujore, siç parashikohet në tabelën II(A) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Tarifa e shërbimit.

a) Kredimarrësi do t'i pagujë Bankës një tarifë shërbimi sipas mënyrës së përcaktuar në tabelën II (B) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Nga Palët në këtë Marrëveshje bihet dakord dhe kuptohet se shuma fillestare e tarifës së shërbimit, e cila referohet në nënseksionin 4.02 (a), është veçse një vlerësim i bazuar në prezumimin e periudhës së zbatimit dhe të periudhës së disbursimit të shumës së plotë të kredisë, siç është konceptuar këtu. Gjithashtu bihet dakord se shuma reale e tarifës së shërbimit do të përlogaritet pas zbatimit të projektit, duke marrë në konsideratë faktin që kjo shumë nuk do të tejkalojë 2.5% (dy pikë pesë për qind) të shumës vjetore të kredisë.

c) Tarifa e shërbimit do të grumbullohet nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03 Vendet e pagesave. Çdo pagesë, duke përfshirë këtu edhe rikthimin e shumës themelore, do të konsiderohet e shlyer kur fondet përkatëse të këtyre pagesave janë kredituar në një llogari të përcaktuar për këtë qëllim nga Banka.

Seksioni 4.04 Pa cenuar tërësinë e dispozitave të seksionit 3.03 të mësipërm, çdo pagesë e mëtejshme do të çmohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt, kur një prej bankave të mëposhtme i konfirmon Bankës për arkëtimin prej saj të kësaj pagese në llogarinë e Bankës:

- nëse kjo pagesë është bërë në dollarë amerikanë:

Llogaria nr. IBAN GB36SINT 609 28000 159111

Gulf International Bank (UK) Limited

One Knightsbridge, London SE1X 7XS

United Kingdom/Britania e Madhe

SEIFT CODE: SINTGB2L

- nëse kjo pagesë është bërë në sterlina britanike:

Llogaria nr. 122432 GBP2520 01

Gulf International Bank B.S.C.

London Branch, One Knightsbridge

London SE1X 7XS

United Kingdom/Britania e Madhe
Teleks Nr. 8812889/8813326 GIBANK G
SËIFT CODE: GULFGB2L

- nëse kjo pagesë është bërë në monedhën euro:
Llogaria nr. IBAN FR76 4389 9000 0196 9650 0151 088
(Union de Banques Arabes et Francaises (UBAF)/
Bashkimi i Bankave Arabe dhe Franceze (BBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex, Francë
Teleks nr. 610334 UBAF
SËIFT CODE: UBAFRPPXXX

Neni 5 **Zbatimi i projektit**

Seksioni 5.01 Kredimarrësi merr përsipër:

a) të zbatojë projektin dhe të drejtojë punimet e tij përmes agjencisë së zbatimit me përkushtim dhe efektivitet në përputhje me të gjitha praktikatat e domosdoshme administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike, nën mbikëqyrjen e personelit dhe drejtuesve të kualifikuar dhe me përvojë, si dhe në përputhje me planin e investimit, buxhetit, planifikimit dhe specifikimit lidhur me projektin që i është dorëzuar Bankës dhe që është miratuar prej saj;

b) të paraqesë në mënyrë të detajuar sipas kërkesave të Bankës, me qëllim miratimi nga ana e saj, të çdo ndryshim të dukshëm që ndodh në buxhetin, planet dhe specifikimet e projektit, si dhe çdo ndryshim thelbësor në secilën prej kontratave për shërbime ose prokurim mallrash që kanë të bëjnë me zbatimin e projektit.

Seksioni 5.02 Pa ndonjë kufizim ose pengesë mbi detyrimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, Kredimarrësi do t'i lejojë Bankës një periudhë kohe të arsyeshme për të dhënë mendimet e veta mbi çdo ndryshim thelbësor ose çdo shtesë të periudhës së rënë dakord në secilën nga kontratat për shërbime ose prokurime mallrash lidhur me zbatimin e projektit.

Neni 6 **Parakushte shtesë përpara disbursimit të fondeve nga Banka**

Kredimarrësi, para se të dorëzojë kërkesën e parë për tërheqjen e fondit, duhet të paraqesë procedurën që propozon të ndiqet, ose që do të ndikojë me qëllim që të vazhdojë procedura për prokurim konkurrues në zbatim të seksionit 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe do të marrë miratimin e Bankës përpara më sipër.

Neni 7 **Dispozita specifike**

Seksioni 7.01 Kredimarrësi do të ketë gjendje, sapo t'i kërkohet, të gjitha shumatat që përfshijnë sasitë e nevojshme për kostot në monedhë vendase dhe kosto shtesë që do të nevojiten për vijueshmërinë e projektit, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën.

Seksioni 7.02 Përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, Kredimarrësi do të trajtojë të gjitha kontratat që financohen nga vazhdimësia e kësaj kredie për zbatimin e projektit në përputhje me procedurat e Bankës dhe udhëzuesin e Bankës në mënyrën e mëposhtme:

i) prokurimi i punimeve civile; nëpërmjet tenderit të hapur ndërkombëtar (ICB), i kufizuar vetëm për vendet anëtare të Bankës;

ii) prokurimi i shërbimeve të konsulencës për projektim, përgatitje të dokumenteve të tenderit dhe mbikëqyrje; nëpërmjet përzgjedhjes së konsulentit nga një listë e shkurtër firmash konsulente të

vendeve anëtare të Bankës;

iii) prokurimi i auditimit financiar; nëpërmjet një përzgjedhjeje konkurruese lokale;

iv) prokurimi i pajisjeve dhe automjetit të zyrës së njësishë së zbatimit të projektit (PMU); nëpërmjet blerjes direkte lokale.

Kredimarrësi do të kërkojë miratim paraprak nga Banka për shpalljen fituese të çdo kontrate, vlera e së cilës tejkalon shumë ekuivalente prej DI 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë dinarë islamikë).

Seksioni 7.03 Kredimarrësi do t'i dorëzojë Bankës, menjëherë pas miratimit prej tij, studimet dhe planet specifike të projektit, afatet e zbatimit të tij dhe çdo ndryshim thelbësor që u bëhet atyre në mënyrë të detajuar, sipas kërkesave të herëpashershme nga ana e Bankës.

Seksioni 7.04 Kredimarrësi do të çelë dhe do të mbajë regjistrat të përshtatshëm për të identifikuar mallrat e financuara nga vijueshmëria e kredisë, me qëllim që të bëjë publik përdorimin e tyre në projekt, të dokumentojë ecurinë e projektit dhe të pasqyrojë në përputhje me praktikën e konsoliduara të kontabilitetit, veprimet dhe pozitën financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.05 Kredimarrësi do të përballojë të gjitha rastet e arsyetuara për vizita nga përfaqësuesit e akredituar të Bankës me qëllime të lidhur me projektin, si dhe për të kontrolluar Projektin, mallrat dhe çdo dokument dhe regjistrat tjetër përkatës, si dhe do t'i paraqesë Bankës të gjitha informacionet sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës lidhur me shpenzimet sipas ecurisë së projektit, mallrave dhe veprimeve, si dhe të pozitës financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.06 Kredimarrësi angazhohet me qëllim për të çuar më tej dhe zbatuar projektin, të marrë të gjitha masat e duhura në mënyrë që institucioni zbatues të funksionojë gjatë gjithë kohës në përputhje me rregullat dhe udhëzimet si në formë, ashtu edhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, si dhe të ketë aftësi administrative dhe drejtues të përshtatshëm për ecurinë e nevojshme dhe efikasë të veprimtarisë së projektit.

Seksioni 7.07 Kredimarrësi do të sigurojë ose ndikojë për pajisjen me sigurime të besueshme të gjitha mallrat e financuara nga zbatimi i kredisë. Këto sigurime do të mbulojnë transportin detar, transitin dhe rreze të tjera rastësore për blerjen dhe importimin e mallrave në territorin e Kredimarrësit dhe dërgimin e tyre në vendin e zbatimit të projektit dhe do të sigurohen në shumën që janë në përputhje me praktikën tregtare të qëndrueshme. Këto sigurime do të bëhen në përputhje me legjislacionin e Kredimarrësit sipas marrëveshjes se mallrat do të risigurohen në një shoqëri që do të paguajë shumën e sigurimit në monedhë lehtësisht të këmbyeshme.

Seksioni 7.08 Kredimarrësi do të veprojë në atë masë që gjykohej e arsyeshme për të disponuar truallin e nevojshëm dhe të drejtat e lidhura me të, siç kërkohet për realizimin e projektit dhe do t'i paraqesë Bankës, me kërkesën e kësaj të fundit, prova të mjaftueshme se trualli dhe të drejtat e lidhura me të janë vënë në shërbim të realizimit të projektit.

Seksioni 7.09 Kredimarrësi do të ndërmarrë veprime nga ana e vet, kur të jetë e nevojshme, për të lejuar agjencisë zbatuese të realizojë projektin dhe nuk do të ndërmarrë ose lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që mund të ndalojë apo ndërhyjë në zbatimin ose veprimtarinë e projektit apo në përmbushjen e çdonjërit prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.10 Të gjitha dokumentet e Bankës, regjistrat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen nga Banka dhe nga Kredimarrësi si çështje konfidenciale.

Seksioni 7.11 Kredimarrësi do të përballojë gjithashtu të gjitha taksat, tarifën dhe detyrimet e lidhura me projektin.

Neni 8 Raportet

Seksioni 8.01

a) Kredimarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar përmbushjen e objektivave të kredisë. Për këtë qëllim, secili prej tyre do t'i dorëzojë tjetrit informacionin e duhur sipas kërkesës së arsyetuar, lidhur me gjendjen e përgjithshme të kredisë. Nga ana e Kredimarrësit, ky informacion do të përfshijë të dhëna lidhur me kushtet ekonomike dhe financiare në shtetin e Kredimarrësit dhe gjendjen e bilancit të pagesave të Kredimarrësit.

b) Kredimarrësi dhe Banka, në mënyrë të herëpashershme dhe mbi bazë të kërkesës së secilës Palë, do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre përmes përfaqësuesve përkatës përsa i takon çështjeve që kanë të bëjnë me qëllimet e kredisë, mbështetjen me shërbimet përkatëse dhe përmbushjen e detyrimeve nga ana e Kredimarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 8.02

a) Kredimarrësi angazhohet të kryejë dorëzimin, ose të ndikojë për dorëzimin në Bankë, të secilit nga raportet e mëposhtme, duke përmbushur tërësisht kërkesat e kësaj të fundit dhe në kohën e përcaktuar:

i) brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga mbarimi i secilit tremujor ose brenda ndonjë afati tjetër që palët mund të bien dakord, raporte për zbatimin e projektit, në atë mënyrë që Banka do të kërkojë herë pas here në mënyrë të detajuar;

ii) raporte të tjera që Banka, në mënyrë të arsyetuar, do të kërkojë lidhur me investimin e shumës së kredisë së disbursuar dhe ecurinë e projektit;

iii) menjëherë pas përfundimit të projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës përfundimtare ose një datë të mëvonshme siç mund të bihet dakord për këtë qëllim nga Kredimarrësi dhe Banka, Kredimarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Bankës një raport të plotë me qëllimet dhe detajet përkatëse, sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, lidhur me zbatimin dhe veprimet fillestare të projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë seksion do të certifikohen sipas vullnetit të lirë të Bankës, në atë mënyrë që Banka do ta gjykojë të arsyeshme.

Neni 9 Vlefshmëria

Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi deri sa:

a) Bankës t'i jepen evidenca të kënaqshme lidhur me zbatimin dhe ndjekjen e kësaj Marrëveshjeje prej Kredimarrësit sipas autorizimit përkatës ose ratifikimit nga të gjitha instancat përkatëse të Qeverisë së Shqipërisë;

b) Kredimarrësi do të dorëzojë një opinion ligjor të pranueshëm për Bankën që buron nga autoriteti ligjor i Kredimarrësit, duke deklaruar se Marrëveshja përbën një detyrim ligjor për Qeverinë e Shqipërisë;

c) Një letër autorizimi do të nënshkruhet nga Ministria e Financave për bankën qendrore se pagesa nga Kredimarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje e shumës themelore dhe kështu e tarifës së shërbimit do të kryhen nga banka qendrore ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, në datat e përcaktuara; dhe

d) Një vërtetim nga banka qendrore, e cila demonstroi se është marrë letra e autorizimit dhe se do t'i bashkëngjitet udhëzimeve të përfshira në të, do t'i dërgohet Bankës nga Kredimarrësi.

Neni 10 Përfundimi i Marrëveshjes për moszbatueshmëri

Nëse Marrëveshja nuk hyn në fuqi brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve të përfshira këtu do të shuhen, përveçse kur Banka pas marrjes në konsideratë të të gjithë shkaqeve të vonësës do të përcaktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij neni. Banka do të njoftojë menjëherë Kredimarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11 Dispozita të ndryshme

Seksioni 11.01 Përfaqësuesit e autorizuar. Ministria e Financave e Kredimarrësit dhe çdo person ose persona që ai do të caktojë me shkrim, do të konsiderohen si përfaqësuesit e autorizuar të Kredimarrësit për qëllime të seksionit 10.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 11.02 Data e Marrëveshjes: Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e Marrëveshjes do të jetë ajo që shfaqet në pjesën hyrëse të saj.

Seksioni 11.03 Adresa. Adresat e mëposhtme janë dhënë për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1
Tiranë, Shqipëri.
Telefon: ++355 4 228 405
Faks: ++355 4 228 494

Për Bankën Islamike për Zhvillim:
P.O. Box: 5925
Jeddah 21432, Mbretëria e Arabisë Saudite
Teleks: 601137 ISDB SJ
Kabëll: BANKISLAMI JEDDAH
Telefaks: 6366871 JEDDAH

Për sa më sipër, Banka dhe Kredimarrësi, secili duke vepruar me anë të përfaqësuesve të vet të autorizuar, nënshkruan këtë Marrëveshje në gjuhën angleze në datën dhe vitin e paraqitur më sipër.

TABELA I PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Përshkrimi i projektit

Objekti kryesor i projektit është sigurimi i një regjimi të pandërprerë trafiku, ulja e kostos operacionale të automjeteve, kursimi i kohës dhe përmirësimi të përgjithshme ekonomike në fushën e projektit nëpërmjet aksesit në rritje dhe lëvizshmërisë. Për më tepër, ura e re do të lejojë trafikun ujor në lumin e Bunës, me projektimin e tij të lëvizshëm. Projekti përbëhet prej komponentëve të mëposhtëm:

1. Punimet civile:

a) Ura. Ura e propozuar e Bunës është 275.5 metra e gjatë, një rrugë e pandërprerë automjeteve, me dy korsi 4.75 metra, trotuare kalimtarësh 2x2.0 metra për një gjerësi totale prej 13.5 metrash.

b) Rrugët hyrëse. Rrugët hyrëse që lidhin të dyja anët e urës së propozuar të Bunës do të jenë me dy korsi, me një gjatësi totale prej 270 metrash dhe gjerësi prej 13.5 metrash.

c) Gjenerator në gjendje gatishmërie. Sigurimi i gjeneratorit në gjendje gatishmërie, që operon me motor dizel me kapacitet të mjaftueshëm në rast mungese energjie, kërkohet për pjesën e lëvizshme të urës.

2. Shërbime konsulence (projektimi dhe mbikëqyrja e detajuar).

3. Njësia e zbatimit të projektit.

4. Kontrolli financiar.

5. Uorkshop fillestar dhe vizitë familjarizuese në mjediset e Bankës së Zhvillimit Islamik.

TABELA II (A) RIPAGESAT E SHUMËS THEMELORE

Shteti: Republika e Shqipërisë
Projekti: Ndërtimi i Urës së Bunës
Shuma e kredisë: DI 6,000,000- (gjashtë milionë dinarë islamikë)
Periudha e kredisë: 25 vjet
Periudha e shtyrjes së afatit: 7 vjet
Tarifa e shërbimit: DI465,660- (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë dinarë islamikë)

Numër	Datë	Shuma themelore (principali) (DI)
-------	------	-----------------------------------

1	31.12. 2013	166,667-
2	30.06. 2014	166,667
3	31.12. 2014	166,667
4	30.06. 2015	166,667
5	31.12. 2015	166,667
6	30.06. 2016	166,667
7	31.12. 2016	166,667
8	30.06. 2017	166,667
9	31.12. 2017	166,667
10	30.06. 2018	166,667
11	31.12. 2018	166,667
12	30.06. 2019	166,667
13	31.12. 2019	166,667
14	30.06. 2020	166,667
15	31.12. 2020	166,667
16	30.06. 2021	166,667
17	31.12. 2021	166,667
18	30.06. 2022	166,667
19	31.12. 2022	166,667
20	30.06. 2023	166,667
21	31.12. 2023	166,667
22	30.06. 2024	166,667
23	31.12. 2024	166,667
24	30.06. 2025	166,667
25	31.12. 2025	166,667
26	30.06. 2026	166,667
27	31.12. 2026	166,667
28	30.06. 2027	166,667
29	31.12. 2027	166,667
30	30.06. 2028	166,667
31	31.12. 2028	166,667
32	30.06. 2029	166,667
33	31.12. 2029	166,667
34	30.06. 2030	166,667
35	31.12. 2030	166,667
36	30.06. 2031	166,667
Totali i shumës themelore për t'u paguar:		6,000,000-

TABELA II (B)
PAGESA E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Shteti: Republika e Shqipërisë

Projekti: Ndërtimi i Urës së Bunës

Shuma e kredisë: DI 6,000,000-(gjashtë milionë dinarë islamikë)

Periudha e kredisë: 25 vjet

Periudha e shtyrjes së afatit: 7 vjet

Tarifa e shërbimit: DI465,660- (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë dinarë islamikë)

Numër	Datë	Tarifa e shërbimit (DI)
1	31.12.2006	18,626

2	30.06.2007	31,044
3	31.12.2007	31,044
4	30.06.2008	31,044
5	31.12.2008	31,044
6	30.06.2009	31,044
7	31.12.2009	31,044
8	30.06.2010	26,077
9	31.12.2010	26,077
10	30.06.2011	26,077
11	31.12.2011	26,077
12	30.06.2012	26,077
13	31.12.2012	26,077
14	30.06.2013	26,077
Totali i tarifës së shërbimit:		465,660-

TABELA III
TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË KREDISË

Shuma e të ardhurave të kredisë së Bankës Islamike për Zhvillim prej DI6,000,000 - (afërsisht i barazvlefshëm me USD8,570,000 {tetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë mijë dollarë amerikanë}) do të tërhiqet për të mbuluar kostot e zërave si më poshtë:

PLANI I PROPOZUAR I FINANCIMIT

Objekti	Shqipëria	Banka e Zhvillimit Islamik	Totali	% e Bankës së Zhvillimit Islamik
i) Punimet civile	0.800	5.622	6.422	90%
ii) Gjeneratori në gjendje gatishmërie dhe instalimi i tij	-	0.800	0.800	100%
iii) Shërbime konsulence (projektimi & mbikëqyrja)	-	0.723	0.723	100%
iv) Njësia e zbatimit të projektit	0.050	0.200	0.250	
v) Kontrolli financiar	-	0.075	0.075	100%
vi) Uorkshop fillestar i projektit dhe vizitë familjarizuese	-	0.030	0.030	100%
Totali	0.850	7.450	8.300	90%
vii) Kontingjencat:				
- çmimi (10%)	0.082	0.748	0.830	90%
- fizike (5%)	0.043	0.372	0.415	90%
Totali i përgjithshëm	0.975	8.570	9.545	90%

2. Sasia e alokuar në këtë tabelë është nxjerrë në bazë të llogaritjeve. Sasitë reale do të vendosen gjatë zbatimit të projektit, sipas kostove reale në sasinë e kredisë.

LIGJ
Nr.9661, datë 18.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË

**SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE PËR PROJEKTIN “CILËSI
DHE BARAZI NË ARSIM”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5174, datë 28.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**HUA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT
KONTRATË FINANCIARE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË
INVESTIMEVE
/ / 2006**

Kjo kontratë lidhet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. /, /, (këtu e tutje referuar si “Huamarrësi”) i palës së parë, dhe Bankës Europiane të Investimeve me qendër në Luksemburg, përfaqësuar nga Z.Gerlando Genuardi, Zëvendëspresident (këtu e tutje referuar si “Banka”) i palës së dytë.

Ndërsa:

1. Huamarrësi ka deklaruar se ka marrë përsipër një projekt (këtu e tutje referuar si “Projekti”), me synim mbështetjen e implementimit të fazës së parë të Strategjisë Kombëtare Arsimore 2004-2015, e përqendruar në përmirësimin e cilësisë së rezultateve mësimore, zgjerimin e trajtimit edhe në arsimin e mesëm dhe përgatitjen e terrenit për reformën terciare në arsim, përshkruar në veçanti në përshkrimin teknik (këtu e tutje referuar si “Përshkrimi teknik”) të pasqyrës A.1 të kësaj kontrate.

2. Kostoja totale e projektit për t’u financuar, sipas vlerësimeve të Bankës, paraqitet si më poshtë:

Burimi	Shuma
Fondet e veta të Huamarrësit	EURO 24, 500,000
Kredi nga Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA)	SDR 10, 500,000
Kredi nga Banka e Zhvillimit e Këshillit të Europës për Zhvillim (“CoEDB”)	EURO 14, 000,000
Kredi nga Banka	EURO 12,500,000
TOTALI	EURO 51,000,000+
	SDR 10,500,000

“SDR” nënkupton të drejtën e veçantë për tërheqje nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, sipas vlerësimeve të tij në përputhje me nenet e kësaj kontrate.

3. Në mënyrë që të plotësohet plani i financimit i përcaktuar në pikën (2), Huamarrësi ka kërkuar nga Banka një kredi të barazvlefshme me shumën 12,500,000 milionë (dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) euro.

4. Në përgjigje të kërkesës së Huamarrësit, të bindur se financimi i projektit rrit kapacitetin e tij dhe duke u mbështetur, ndër të tjera, në fakte dhe deklarata të cituara në këto pika, Banka është e gatshme që të vërë në dispozicion të Huamarrësit mbi bazën e kësaj kontrate financiare një kredi të barazvlefshme me shumën 12,500,000 milionë (dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) euro, (këtu e tutje referuar si “Kontrata”).

5. Disbursimi i çdo kësti (siç përcaktohet në nenin 1.02(1) të kësaj kontrate) i nënshtrohet plotësimit të detyrimeve të vendosura në nenet 6.05 dhe 6.06 të kësaj kontrate nga ana e Huamarrësit.

6. Në mënyrë që të harmonizohet mbështetja financiare kundrejt Huamarrësit për implementimin e projektit e siguruar nga Banka, IDA dhe CoEDB, Banka është e gatshme të nënshkruajë një memorandum mirëkuptimi për t’u iniciuar nga dhe ndërmjet Huamarrësit, Bankës, IDA-s dhe CoEDB-së në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate ose rreth kësaj date (memorandumi i mirëkuptimit këtu e tutje referuar si “MOU”). Më pas, MOU mund të nënshkruhet nga çdo vend tjetër, institucion ose organizëm, të cilët kanë për qëllim të kontribuojnë në burimet financiare të projektit në bazë të marrëveshjes së Bankës, IDA-s, COEDB-së dhe Huamarrësit.

7. MOU hyn në fuqi pas nënshkrimit (i) të kësaj kontrate dhe (ii) marrëveshjeve për t’u lidhur nga dhe ndërmjet Huamarrësit, IDA-s dhe CoEDB-së, me qëllim sigurimin e kontributeve financiare në mbështetje të projektit.

8. Implementimi i projektit do të udhëhiqet nga një manual operacional i programit (këtu e tutje referuar si “POM”) për të cilin Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Huamarrësit (këtu e tutje referuar si “Agjencia mbështetëse”), Banka, IDA dhe CoEDB do të bien dakord midis tyre. Ndër të tjera, POM do të vendosë procedura të përbashkëta mjedisore dhe prokurimi, tregues monitorimi dhe organizim paraprak për raportin financiar dhe të ecurisë.

9. Marrëveshja kuadër që rregullon aktivitetet e Bankës në territorin e Shqipërisë, e nënshkruar më 5 shkurt 1998 ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës (këtu e tutje referuar si “Marrëveshja kuadër”) është e zbatueshme në këtë kontratë.

10. Statuti i Bankës parashikon se Banka do të garantojë që fondet e saj të përdoren në mënyrë sa më të arsyeshme në interes të Bashkimit Europian dhe për rrjedhojë, termat dhe kushtet e operacioneve të huasë duhet të jenë në përputhje me politikat përkatëse të Bashkimit Europian.

11. Referimet në këtë dokument ndaj neneve, pikave dhe pasqyrave janë referime përkatësisht të neneve, pikave, pasqyrave dhe shtojcave të kësaj kontrate.

Si rrjedhojë, është rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Kredia dhe disbursimi

1.01 Shuma dhe alokimi i kredisë

Me anë të kësaj kontrate, Banka vë në dispozicion të Huamarrësit, i cili pranon një kredi (këtu e tutje referuar si “Kredia”) në shumën e barazvlefshme me 12,500,000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) euro për financimin e projektit.

1.02 Procedura e disbursimit

1.02(1) Këstet

Banka do të disbursojë kredinë gjatë një periudhe deri në pesë vjet. Shuma e secilit këst, nëse nuk është i fundit, do të jetë të paktën ekuivalenti i shumës prej 2,000,000 (dy milionë) euro. Kësti i kërkuar nga Huamarrësi në përputhje me nenin 1.02(2) këtu e tutje referohet si “Kësti”.

1.02 (2) Kërkesa për disbursim

Herë pas here deri më 31 dhjetor 2009, Huamarrësi mund t’i paraqesë Bankës një kërkesë me shkrim (një “Kërkesë për disbursim”), kryesisht në formularin e paraqitur në pasqyrën C për

disbursimin e një kësti. Kërkesa për disbursim do të specifikojë:

- i) shumën dhe monedhën e disbursimit të këstit;
- ii) datën e preferuar për disbursim, e cila do të jetë një ditë pune zyrtare (e përcaktuar në nenin 5.01), që përkon me jo më pak se 15 ditë kalendarike nga data e kërkesës për disbursim, duke marrë parasysh se Banka mund ta disbursojë këstin deri në katër muaj kalendarike nga data e kërkesës për disbursim;
- iii) nëse kësti mbart një normë fikse interesi (d.m.th. është këst me normë fikse interesi) ose me normë të ndryshueshme interesi me shtrirje kohore të papërcaktuar (d.m.th. një këst me shtrirje kohore të përcaktuar dhe interes variabël ose kësti FSFR), në të dyja rastet në bazë të dispozitave përkatëse të nenit 3.01;
- iv) periudha e preferuar për pagesën e interesit të këstit, përcaktuar në përputhje me nenin 3.01;
- v) afatet e preferuara për shlyerjen e principalit, përcaktuar në përputhje me nenin 4.01; dhe
- vi) datat e preferuara për pagesën, përcaktuar në përputhje me nenin 5.01.

Huamarrësi, gjithashtu, me dëshirën e tij mund të specifikojë në kërkesën për disbursim elementet e mëposhtme përkatëse, nëse ka, të përcaktuara nga Banka pa detyrimin për t'u aplikuar për këstin gjatë kohëzgjatjes së tij, d.m.th:

- i) në rastin e një kësti me normë fikse interesi, normën e interesit; dhe
- ii) në rastin e një kësti me shtrirje kohore të përcaktuar dhe interes variabël, shtrirjen (përcaktuar në nenin 3.01).

Për qëllime të kësaj kontrate në përgjithësi, “Norma ndërbankare përkatëse” nënkupton:

- EURIBOR, në rastin e një kësti emërtuar në euro;
- LIBOR, në rastin e një kësti emërtuar në GBP ose USD dhe
- norma e tregut dhe përcaktimi i saj sipas Bankës komunikuar Huamarrësit veças, në rastin e një kësti emërtuar në një monedhë tjetër.

Duke iu referuar paragrafit të parafundit të nenit 1.02(3), çdo kërkesë për disbursim është e përvokueshme.

1.02(3) Njoftimi për disbursim

Ndërmjet dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së disbursimit të këstit, nëse kërkesa për disbursim është në përputhje me nenin 1.02(2), Banka do t'i dërgojë Huamarrësit një njoftim (këtu e tutje referuar si “Njoftim disbursimi”, i cili do të specifikojë:

- i) shumën dhe monedhën që do të disbursohet;
- ii) datën në të cilën kësti planifikohet të disbursohet (këtu e tutje referuar si “Data e planifikuar e disbursimit”), disbursimi në çdo rast i nënshtrohet dispozitave të nenit 1.04;
- iii) baza e normës së interesit;
- iv) për një këst me normë fikse interesi, normën fikse të interesit dhe për një këst me shtrirje kohore të përcaktuar dhe interes variabël, shtrirjen kohore;
- v) afatet e ripagimit të principalit dhe periudha e pagimit të interesit; dhe
- vi) datat e zbatueshme të shlyerjes.

Nëse një ose më shumë nga elementet e përcaktuara në njoftimin e disbursimit nuk është në përputhje me elementin korrespondues, çfardoqoftë, në kërkesën për disbursim, Ministria e Financave e Huamarrësit, duke vepruar në emër të Huamarrësit, brenda tre (3) ditëve zyrtare të Luksemburgut, pas marrjes së njoftimit për disbursim, mund ta anulojë kërkesën për disbursim duke njoftuar Bankën dhe për rrjedhojë kërkesa dhe njoftimi për disbursim nuk kanë më vlerë.

Kryesisht për qëllim të kësaj kontrate, “Ditë pune e Luksemburgut” nënkupton një ditë kur hapen bankat tregtare.

1.03 Monedha dhe llogaritja e disbursimit

1.03 (1) Monedha e disbursimit

Në varësi të disponueshmërisë, Banka do të disbursojë çdo këst në monedhën për të cilën Huamarrësi ka shprehur preferencën. Monedhat që disbursohen do të jenë në euro, USD ose GBP ose çdo monedhë tjetër e cila është gjerësisht e tregtueshme në tregjet e huaja kryesore të shkëmbimit dhe që në rastin e një kësti me shtrirje kohore të përcaktuar dhe interes variabël, është një monedhë e disponueshme nga Banka me norma interesi variabël.

Për llogaritjen e shumës së disponueshme për t'u disbursuar në monedha të ndryshme nga euro dhe për të përcaktuar ekuivalentin në euro, Banka do të aplikojë normën e publikuar nga Banka

Qendrore Europiane në Frankfurt në atë datë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve para disbursimit, sipas vendimit të Bankës.

1.03 (2) Llogaritja e disbursimit

Shuma e çdo kësti do të disbursohet nga ana e Bankës në numrin e llogarisë së Huamarrësit pas njoftimit me shkrim të tij jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së planifikuar të disbursimit.

Huamarrësi miraton se çdo transfertë shume nga ana e Bankës në mënyrën e përcaktuar më sipër, rrit bilancin e papaguar të huasë (përcaktuar më poshtë) si pasojë e shumës së transferuar.

1.04 Kushtet e disbursimit

1.04(1) Kësti i parë

Disbursimi i këstit të parë në bazë të kësaj kontrate do t'i nënshtrohet plotësimit me sukses sipas Bankës të kushteve të mëposhtme, d.m.th. që gjatë ose para plotësimit të shtatë (7) ditëve zyrtare të Luksemburgut para datës së planifikuar për disbursim:

i) Banka ka marrë një mendim zyrtar të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë së Huamarrësit, në të cilin konfirmohet se:

a) zbatimi i kësaj kontrate ka marrë autorizimin e duhur në bazë të një vendimi të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit, se nënshkruesit e kësaj kontrate kanë autorizimin e duhur për të nënshkruar në emër të Huamarrësit, se kjo kontratë përkon me qëllimin e Marrëveshjes kuadër, se parlamenti i Huamarrësit e ka ratifikuar siç duhet këtë kontratë, se dispozitat e kësaj kontrate janë në fuqi vepruese dhe se ajo është e vlefshme, e detyrueshme dhe e zbatueshme në Shqipëri në përputhje me kushtet e saj;

b) prova që vërtetojnë autoritetin e personit apo personave të autorizuar për të nënshkruar kërkesa disbursimi dhe mostra të vërtetuara të firmave të person/ave të tillë; dhe

c) se të gjitha miratimet e nevojshme të kontrollit të shkëmbyer janë siguruar në mënyrë që të lejojnë Huamarrësin të marrë shumat e disbursuara në bazë të kësaj kontrate, të shlyejë huanë dhe të paguajë interesin dhe të gjitha shumat e tjera që rrjedhin nga kjo kontratë dhe se miratime të tilla të shprehen me hapjen dhe ruajtjen e llogarive kundrejt të cilave Huamarrësi do të adresojë Bankën për të disbursuar kredinë;

ii) agjencia mbështetëse i ka dorëzuar Bankës versionin përfundimtar të POM-it në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

1.04 (2) Të gjitha këstet

Disbursimi i çdo kësti sipas nenit 1.02, përveç të parit, kushtëzohet nga marrja nga ana e Bankës në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, para plotësimit të shtatë (7) ditëve zyrtare të Luksemburgut nga afati i datës përkatëse të planifikuar për disbursim:

i) prova se Huamarrësi është zotuar ose angazhuar nga ana kontraktuale deri në datën e kërkesës për disbursim për të siguruar shpenzime kualifikuese brenda (90) ditëve nga data e disbursimit të planifikuar me një shumë totale të paktën të barazvlefshme me 80% të sasisë së këstit që do të paguhet dhe të të gjitha kësteve paraardhëse; "Shpenzime kualifikuese" nënkuptojnë shpenzime (përfshirë koston e hartimit dhe kontrollit, nëse ekziston, dhe taksat e detyrimit neto që paguhet nga ana e Huamarrësit) të kryera nga Huamarrësi që kanë të bëjnë me punimet, mallrat dhe shërbimet e specifikuar në përshkrimin teknik si të pranueshme për t'u financuar në kuadrin e kësaj kredie, kontraktimi/kontraktimet e të cilave do të jetë kryer sipas kushteve të pranueshme nga Banka dhe në përputhje me POM-in;

ii) prova se fondet e përmendura në pasqyrën (2) për zbatimin e projektit janë në dispozicion të Huamarrësit;

iii) një konfirmim të kohëve të fundit se nuk nevojiten miratime kontrolli të përbashkëta shtesë në mënyrë që të lejohet marrja e këstit që do të paguhet në bazë të kësaj kontrate, shlyerja e huasë dhe interesit, si dhe shlyerja e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, dhe

iv) prova që vërtetojnë autorizimin e personit/personave për të nënshkruar kërkesa për disbursim, si dhe mostra autentike të firmave të personit/ave të tillë, nëse nuk janë personi/personat e autorizuar të cilët kanë nënshkruar kërkesat e para për disbursim.

Për llogaritjen e ekuivalentit të shumave të shpenzuara në euro, Banka do të aplikojë kursin e këmbimit të specifikuar në nenin 1.03.

1.04(3) Kësti i fundit

Paraqitja e kërkesës për pagimin e këstit të fundit sipas nenit 1.02(1) kushtëzohet nga marrja

nga ana e Bankës në formë dhe përmbajtje të pranueshme prej saj të dokumenteve të Huamarrësit, ku tregohet në mënyrë bindëse për Bankën se mund të jetë e arsyeshme të mendohet që Huamarrësi do të ketë kryer shpenzime kualifikuese brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e preferuar për një pagesë të tillë të specifikuar në kërkesën për disbursim, në masën totale të paktën të barasvlefshme me 100% të shumave të kësteve të mëparshme të paguara dhe të këstit që do të paguhet.

1.04(4) Dispozita të përgjithshme mbi kushtet e disbursimit

Në rast se kërkesa për disbursim është kryer pa plotësuar kushtet e specifikuara në nenin 1.04, një kërkesë e tillë për disbursim do të ishte marrë prej Bankës në datën kur ajo të ishte e bindur se kushtet në fjalë janë plotësuar.

Pavarësisht nga dispozita e paragrafit paraardhës, nëse një pjesë e dokumenteve të pranuar sipas nenit 1.04 nuk janë të pranueshme nga ana e Bankës, Banka mund të paguajë pa cenuar shumën minimale të përcaktuar në nenin 1.02(1), një shumë të barabartë me shumën e kërkuar në kërkesën përkatëse për disbursim pa shumën korresponduese të shpenzimeve kualifikuese të padokumentuara paraprake.

1.05 Shtyrja e afatit të disbursimit

1.05(1) Arsytet për shtyrjen e afatit

Pasi të ketë marrë një kërkesë me shkrim nga Huamarrësi, Banka do të shtyjë në një datë të specifikuar nga Huamarrësi afatin e pagimit të këstit plotësisht ose pjesërisht, me kusht që kjo datë të mos jetë më shumë se gjashtë muaj nga data e planifikuar për disbursim. Në këtë rast, Huamarrësi do të paguajë dëmshpërblim për shtyrje afati, siç përcaktohet në nenin e mëposhtëm 1.05 (2). Çdo kërkesë për shtyrje afati aplikohet për një këst, vetëm nëse kërkesa bëhet të paktën pesë (5) ditë zyrtare të Luksemburgut para datës së planifikuar të disbursimit.

Në rast se ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 1.04 nuk plotësohet në datën e specifikuar, disbursimi do të shtyhet për një datë ku Banka dhe Huamarrësi do të bien dakord që nuk do të jetë më pak se pesë (5) ditë zyrtare të Luksemburgut pas plotësimit të të gjitha kushteve të disbursimit.

1.05 (2) Dëmshpërblimi për shtyrje afati

Nëse pagimi i një kësti të njoftuar (përcaktuar më poshtë në nenin 1.05(2)) shtyhet, qoftë me kërkesë të Huamarrësit ose për arsye të mosplotësimit të kushteve të disbursimit, me kërkesë të Bankës, Huamarrësi do të paguajë një dëmshpërblim mbi shumën, disbursimi i së cilës është shtyrë. Një dëmshpërblim i tillë do të rritet nga data e planifikuar për disbursim deri në datën aktuale të disbursimit ose sipas rastit, deri në datën e anulimit të këstit, me një normë të barabartë me R1 minus R2, ku:

- “R1” nënkupton normën e interesit që do të aplikohet herë pas here në bazë të nenit 3.01 dhe njoftimit për disbursimin përkatës, nëse kësti do të ishte paguar në datën e planifikuar për disbursim

dhe

- “R2” nënkupton normën ndërbankare përkatëse pa 0.125% (12.5 pikë bazë), me kusht që për të përcaktuar normën ndërbankare përkatëse sipas nenit në fjalë 1.05, periodhat përkatëse të parashikuara në pasqyrën II do të jenë periodha që pasojnë njëra-tjetrën të një muaji që fillon në datën e disbursimit të planifikuar.

Për më tepër, dëmshpërblimi:

a) nëse shtyrja e afatit kalon periudhën njëmuajore, shtohet në fund të çdo muaji dhe paguhet në përputhje me nenin 1.07;

b) llogaritet duke përdorur marrëveshjen e numërimit ditor e zbatueshme për R1;

c) ku R2 e tejkalon R1, do të vendoset në normën zero; dhe

d) do të paguhet në përputhje me nenin 1.07.

Në këtë kontratë një “Këst i njoftuar” nënkupton një këst për të cilin Banka ka lëshuar një njoftim disbursimi.

1.05(3) Anulimi i disbursimit të shtyrë për një periudhë gjashtëmuajore

Duke lajmëruar Huamarrësin, Banka mund të anulojë një disbursim të cilit i është shtyrë afati në bazë të nenit 1.05(1) me më shumë se gjashtë muaj në total. Shuma e anuluar do të jetë e

disponueshme për disbursim sipas nenit 1.02.

1.05 Anulimi dhe pezullimi

1.06(1) E drejta e Huamarrësit për anulim

Me anë të një lajmërimi drejtuar Bankës, Huamarrësi, në çdo kohë, mund të anulojë plotësisht ose pjesërisht dhe me efekt të menjëhershëm pjesën e papaguar të kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk do të ketë efekt mbi një këst të njoftuar, data e planifikuar e disbursimit të të cilit përfshihet brenda pesë (5) ditësh zyrtare të Luksemburgut pas datës së njoftimit.

1.06 (2) E drejta e Bankës për pezullim dhe anulim

Duke lajmëruar Huamarrësin, Banka mund të anulojë dhe/ose pezullojë plotësisht ose pjesërisht dhe me efekt të menjëhershëm pjesën e papaguar të kredisë:

i) si pasojë e një rasti të përmendur në nenin 10.01;

ii) në situata të veçanta që ndikojnë negativisht në aksesin e Bankës në tregun financiar, përveç rastit të një kësti të njoftuar; dhe

iii) nëse, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, Banka nuk është e bindur nga plotësimi i garancive dhe zotimeve të dhëna nga Huamarrësi në nenet 6.06 dhe 8.04.

Për më tepër, në shkallën që Banka mund të anulojë kredinë në bazë të nenit 4.03(1), Banka gjithashtu mund ta pezullojë atë. Çdo pezullim do të vazhdojë derisa Banka t'i japë fund atij ose të anulojë shumën e pezulluar.

1.06(3) Dëmshpërblimi për pezullimin dhe anulimin e një kësti

1.06(3)(i) Pezullimi

Në rast se Banka pezullon një këst të njoftuar për arsye të përmendura në nenin 10.01 por jo për arsye të tjera, Huamarrësi do të dëmshpërblejë Bankën sipas nenit 1.05(2).

1.06(3)(ii) Anulimi

Në rast se një këst i njoftuar me normë fikse interesi anulohet nga Huamarrësi sipas nenit 1.06(1) të mësipërm, Huamarrësi do të dëmshpërblejë Bankën sipas nenit 4.02(2)(i). Nëse ndonjë pjesë e kredisë përveç këstit të njoftuar me normë fikse interesi anulohet nga Huamarrësi sipas nenit 1.06(1) të mësipërm, nuk paguhet dëmshpërblim.

Në rast se Banka anulon pagimin e një kësti me normë fikse interesi sipas nenit 1.05(3), Huamarrësi do të dëmshpërblejë Bankën sipas nenit 4.02(2)(i). Nëse Banka anulon një këst të njoftuar si pasojë e një arsyeje të përmendur në nenin 10.01, Huamarrësi do të dëmshpërblejë Bankën sipas nenit 10.03. Përveç këtyre rasteve, nuk paguhet asnjë dëmshpërblim kur anulimi kryhet nga Banka.

Dëmshpërblimi do të llogaritet në ditën e lajmërimit për anulim, duke marrë parasysh se shuma e anuluar mendohet të ishte paguar ose shlyer në datën e planifikuar për disbursim ose duke marrë parasysh se pagimi i këstit është tashmë i shtyrë në kohë ose i pezulluar.

1.06(4) Anulimi pas mbarimit të afatit të kredisë

Në çdo kohë pas skadimit të afatit për Huamarrësin për të paraqitur një kërkesë disbursimi, me njoftim të Huamarrësit dhe pa detyrime nga asnjë palë, Banka mund të anulojë çdo pjesë të kredisë me përjashtim të këstit të njoftuar.

1.07 Shumat e pagueshme sipas nenit 1

Shumat e pagueshme në bazë të neneve 1.05 dhe 1.06 do të paguhën në monedhën e këstit në fjalë. Ato do të paguhën brenda shtatë ditëve nga marrja nga ana e Huamarrësit e kërkesës së Bankës ose brenda një periudhe më të gjatë kohore, të specifikuar në lajmërimet e Bankës për nevojat e saj.

Neni 2

Kredia

2.01 Shuma e kredisë

Huaja e kredituar (këtu e tutje referuar si “Huaja”) do të përbëjë totalin e shumave të disbursuara nga Banka në monedhën e disbursimeve, të njoftuara nga Banka në rastin e pagimit të çdo kësti.

2.02 Monedha në të cilën do bëhen shlyerjet

Çdo shlyerje e një kësti sipas nenit 4 ose, sipas rastit, nenit 10, do të jetë në monedhën e këstit.

2.03 Monedha e interesit dhe detyrimeve të tjera

Interesi dhe çdo detyrim tjetër për t'u paguar nga ana e Huamarrësit sipas neneve 3, 4 dhe kur është e zbatueshme, nenit 10, do të llogaritet dhe paguhet për çdo kësht në monedhën e kështit.

Çdo pagesë tjetër do të kryhet në monedhën e specifikuar nga Banka, duke marrë parasysh monedhën e shpenzimeve që do të paguhet me anë të asaj pagese.

2.04 Konfirmimi nga Banka

Pas çdo pagimi të një kështi, Banka do t'i dorëzojë Huamarrësit një deklaram përmbledhës, ku tregohet data e disbursimit, monedha dhe shuma, kushtet e shlyerjes, si dhe norma e interesit e përgjithshme dhe për kështin në fjalë. Ky konfirmim do të përfshijë një tabelë amortizimi.

Neni 3 Interesi

3.01 Norma e interesit

3.01(1) Kështet me normë fikse

Huamarrësi do të paguajë interes mbi bilancin e papaguar të çdo kështi me normë fikse dy herë në vit ose çdo vit të vonuar në datat përkatëse të pagesës, siç specifikohet në njoftimin e disbursimit përkatës, duke filluar nga data e parë e një pagese të tillë pas pagimit të kështit.

Interesi do të llogaritet në bazë të nenit 5.02(i) me normë vjetore që është norma fikse.

Në këtë kontratë, "Norma fikse" nënkupton një normë interesi vjetore të përcaktuar nga Banka në përputhje me parimet e zbatueshme të vendosura herë pas here nga organet drejtuese të Bankës për hua të akorduara me normë fikse interesi, të emëtuara në monedhën e kështit dhe që mbartin kushte të njëjta për shlyerjen e kapitalit dhe pagimin e interesit.

3.01(2) Kështe me shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël

Huamarrësi paguan interes për bilancin e papaguar për çdo kësht me shtrirje fikse dhe interes variabël (përcaktuar më poshtë) për vonesat vjetore ose gjashtëmujore nga datat përkatëse të pagesës, sipas specifikimeve në njoftimin përkatës të disbursimit.

Banka njofton Huamarrësin në lidhje me shtrirjen kohore fikse dhe normën e interesit variabël brenda dhjetë (10) ditëve nga fillimi i çdo periudhe reference me shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël.

Interesi do të llogaritet për çdo periudhe reference me shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël mbi bazën e nenit 5.02 (ii).

Në këtë kontratë:

"FSFR" nënkupton shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël, d.m.th. një normë interesi të barabartë me normën ndërbankare përkatëse plus ose minus shtrirjen, përcaktuar nga Banka për çdo periudhë reference pasardhëse me shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël.

"Periudhë reference FSFR" nënkupton çdo periudhë tre ose gjashtëmujore nga një datë pagese deri në datën e pagesës tjetër përkatëse, me kusht që periudha e parë e referencës me shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël të fillojë në datën e pagimit të kështit.

"Shtrirje" nënkupton një shtrirje fikse të normës ndërbankare përkatëse (plus ose minus) e përcaktuar nga Banka dhe njoftuar Huamarrësit në lajmërimin e disbursimit përkatës.

3.02 Interesi për shumat që u ka kaluar afati

Pa cenuar nenin 10 dhe në vend të përjashtimit ndaj nenit 3.01, interesi shtohet për çdo shumë që i ka kaluar afati për t'u paguar sipas kushteve të kësaj kontrate nga data e caktuar deri në datën e pagesës me normë interesi të barabartë me normën ndërbankare përkatëse plus 2% (200 pikë bazë) dhe do të paguhet në përputhje me kërkesën e Bankës. Për të vendosur normën ndërbankare përkatëse sipas këtij neni 3.02, periudhat përkatëse brenda kuptimit të pasqyrës II do të jenë periudha pasuese të një muaji që fillojnë në datën e caktuar.

Megjithatë, interesi mbi një kësht me normë fikse do të përcaktohet në bazë të normës vjetore që përbëhet nga shuma e normës së interesit përcaktuar në nenin 3.01(1) plus 0.25% (25 pikë bazë) nëse ajo normë vjetore interesi tejkalon, për çdo periudhë të dhënë përkatëse, normën e specifikuar në paragrafin paraprirës.

Në rast se shuma të cilës i ka kaluar afati është në një monedhë ndryshe nga ajo e huasë, do të aplikohet norma vjetore e mëposhtme, d.m.th. norma ndërbankare përkatëse e cila përdoret nga Banka për transaksione në atë monedhë plus 2% (200 pikë bazë), të llogaritura në përputhje me praktikën e

tregut për një normë të tillë.

Neni 4 Shlyerja

4.01 Shlyerja normale

Huamarrësi do të shlyejë çdo këst me këste në datat e pagesës, të përcaktuara në nenin 5.01 dhe të specifikuara në lajmërimet përkatëse për disbursim në përputhje me kushtet e tabelës së shlyerjes të paraqitur sipas nenit 2.04.

Çdo tabelë shlyerjeje do të përpilohet në mënyrë që:

i) të bëhet shlyerja e kështit:

a) në rastin e një kësti me normë fikse ose (i) me këste të barabarta vjetore apo gjashtëmujore të principalit ose (ii) me bazë këstesh vjetore konstante, në mënyrë që totali i principalit dhe interesit për t'u paguar si pjesë e kështit të jetë mundësisht i njëjtë në çdo datë shlyerjeje; dhe

b) në rastin e një kësti me shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël me këste të barabarta vjetore apo gjashtëmujore të principalit; dhe

ii) data e parë e shlyerjes së çdo kësti të jetë një datë shlyerjeje që bie jo më vonë se data e shlyerjes së parë, e cila pason menjëherë përvjetorin e shtatë të datës së disbursimit të kështit dhe data e fundit e shlyerjes do të jetë një datë shlyerjeje që bie jo më herët se katër (4) vjet dhe jo më vonë se njëzet e pesë (25) vjet nga data e disbursimit.

Dita e fundit e shlyerjes së një kësti, specifikuar në bazë të këtij neni 4.01, përcaktohet nga ky moment si data e maturimit.

4.02 Parapagimi vullnetar

4.02(1) Opsioni i parapagimit

Kushtëzuar nga nenet 4.02(2) dhe 4.03(4), Huamarrësi mund të parapaguajë krejtësisht ose pjesërisht kështin, bashkë me interesin përkatës, duke njoftuar me shkrim një muaj para (këtu e tutje referuar si "Njoftim parapagimi") dhe specifikuar shumën që do të parapaguhet ("Shuma që parapaguhet") dhe datën në të cilën Huamarrësi propozon të kryejë parapagimin ("Data e parapagimit"), e cila do të jetë data e pagimit për atë këst.

4.02(2) Zhdëmtimi i parapagimit

4.02(2)(i) Këst me normë fikse

Në lidhje me shumën e parapaguar të një kësti me normë fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës në datën e parapagimit një dëmshpërblim të barasvlefshëm me vlerën reale (si të datës së parapagimit) të shtesës, nëse ka, të:

i) interesit që do të shtohet pas kësaj mbi shumën e parapagimit nga periudha e datës së parapagimit deri në datën e maturimit, nëse nuk do të ishte parapaguar, mbi

ii) interesin që do të shtohet gjatë asaj periudhe, nëse do të llogaritej në bazë të normës së rishpërndarjes EIB (përcaktuar më poshtë), 15 pikë bazë më pak.

Kjo vlerë e mësipërme do të llogaritet me një normë zbritje të barasvlefshme me normën e rirreshtimit EIB, e aplikuar në çdo datë pagese përkatëse.

Në këtë kontratë "Normë e rishpërndarjes EIB" nënkupton normën fikse në fuqi një muaj para datës së parapagimit që ka kushte të njëjta për pagesën e interesit dhe të njëjtin profil parapagimi kundrejt datës së maturimit si atë të shumës së parapagimit.

4.02(2)(ii) Kësti me shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël

Huamarrësi mund të parapaguajë një këst me shtrirje kohore fikse dhe normë interesi variabël pa dëmshpërblim në ndonjë nga datat e pagesës përkatëse.

4.02(3) Sistemi i parapagimit

Banka do të njoftojë Huamarrësin, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e parapagimit, në lidhje me shumën e parapagimit, interesin e rritur deri atëherë dhe në rastin e parapagimit të një kësti me normë fikse ose të një kësti me shtrirje fikse por interesi variabël, mbi dëmshpërblimin që duhet paguar në bazë të nenit 4.02(2) ose sipas rastit, mbi mosekzistencën e një dëmshpërblimi.

Jo më vonë se afati i pranimit (përcaktuar më poshtë), Huamarrësi do të lajmërojë Bankën:

i) që Banka të konfirmojë njoftimin e parapagimit me kushtet e specifikuara prej saj; ose

ii) që të tërheqë njoftimin e parapagimit.

Në rast se Huamarrësi jep konfirmimin sipas pikës (i), atëherë ai do të kryejë parapagimin. Nëse Huamarrësi tërheq njoftimin e parapagimit ose nuk e konfirmon atë në kohë, ai mund të mos e kryejë parapagimin. Përveç rasteve të mësipërme, njoftimi i parapagimit është i detyrueshëm dhe i pakthyeshëm.

Huamarrësi do ta shoqërojë parapagimin e shumës përkatëse që do të parapaguhet me pagesën e interesit të shtuar dhe dëmshpërblimin, në rast se ka.

Për qëllim të këtij neni 4.02, “Afati i pranimit” për njoftim është:

i) ora 16:00 me orën e Luksemburgut në ditën e nisjes, nëse njoftimi është nisur në orën 14:00 në një ditë zyrtare të Luksemburgut; ose

ii) ora 11:00 e ditës pasardhëse, e cila është ditë pune Luksemburgu, nëse njoftimi niset pas orës 14:00 me orën e Luksemburgut në një ditë të tillë ose niset në një ditë që nuk është ditë pune zyrtare në Luksemburg.

4.03 Parapagimi i detyrueshëm

4.03(1) Arsyet për parapagim

4.03(1)(i) Ulja e kostos së projektit

Në rast se kostoja totale e projektit duhet të ulet nga shifrat e përmendura në pasqyrën (2) në një nivel në të cilin shuma e kredisë tejkalon 50% të një kostoje të tillë, Banka, nëse dhe në shkallën që ajo nuk mund të rikthejë një përqindje maksimale duke anuluar një sasi proporcionale të kredisë, mund të kërkojë parapagimin e asaj pjese të huasë, siç kërkohet për të rikthyer këtë përqindje maksimale, duke lajmëruar Huamarrësin.

4.03(1)(ii) Paralelisht me shlyerjen e një kredie tjetër me afat

Nëse Huamarrësi parapaguan vullnetarisht një pjesë të një kredie tjetër apo të një detyrimi tjetër financiar ose kredie pjesërisht ose plotësisht, me afat maturimi, në kohën e parapagimit, të më shumë se pesë vjetëve (këtu e tutje referuar si “Hua me afat”) ndryshe sesa prej të ardhurave të huasë me afat të paktën të barabartë me afatin e pambaruar të huasë që parapaguhet, atëherë Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë kredinë ose të kërkojë parapagim të huasë në përpjesëtim të tillë sa shuma e shlyer e kredisë me afat kundrejt shumës totale të papaguar të të gjitha huave me afat.

Banka do të njoftojë Huamarrësin brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e lajmërimit sipas nenit 8.02 (ii).

4.03(2) Detajet e parapagimit

Çdo shumë e kërkuar nga Banka sipas nenit 4.03(1), bashkë me interesin e shtuar, do të paguhet në datën e përcaktuar nga Banka, datë e cila nuk do të jetë më pak se tridhjetë (30) ditë nga data e njoftimit të Bankës për kërkesë.

Nëse, për më tepër, sipas ndonjë dispozite të këtij neni 4.03(2), Huamarrësi parapaguan një kësht në një ditë ndryshe nga ajo e një date pagese përkatëse, Huamarrësi do të dëmshpërblejë Bankën në një shumë të tillë siç Banka e vërteton se nevojitet për ta kompesuar për marrjen e fondeve jashtë datës përkatëse të pagesës.

4.03(3) Aplikimi për parapagim të pjesshëm

Nëse Huamarrësi parapaguan një kësht pjesërisht, shuma e parapagimit do të aplikohet proporcionalisht ose, me opsionin, e mandatit të anasjellë të maturimit për çdo kësht të papaguar.

Nëse Banka kërkon një parapagim të pjesshëm të huasë, Huamarrësi, në pajtim me kërkesën, duke njoftuar Bankën, nisur brenda pesë (5) ditëve pune zyrtare Luksemburgu nga marrja e kërkesës së Bankës, mund të zgjedhë kështet që do të parapaguhet dhe ushtrojë mundësinë për të aplikuar për shumën e parapaguara.

Neni 4 nuk do të cenojë nenin 10.

Neni 5

Pagesat

5.01 Përcaktimi i datës së pagesës

Në këtë kontratë “Data e pagesës” nënkupton:

i) për një kësht me normë fikse interesi, 15 maji dhe 15 nëntori i çdo viti; dhe

ii) për një kësht me normë interesi variabël e shtrirje fikse, përvjetori ose gjashtëmujori i datës së disbursimit deri në datën e maturimit, duke pasur parasysh që në rast se një datë e tillë nuk i përket

një dite zyrtare pune përkatëse, atëherë ajo nënkupton:

iii) për një këst me normë fikse ditën zyrtare të punës vijuese, pa llogaritur interesin sipas nenit 3.01;

iv) për një këst me normë interesi variabël e shtrirje fikse, ditën pasuese, nëse ka, të atij muaji kalendarik që i përket një dite pune zyrtare përkatëse ose në pamundësi të saj, ditën më të afërt vijuese që i përket një dite pune zyrtare, duke llogaritur interesin korrespondues sipas nenit 3.01; dhe

“Ditë pune zyrtare përkatëse” nënkupton:

i) për euro, një ditë në të cilën operon sistemi i pagesës TARGET (Transferte transeuropiane e automatizuar ekspres e shlyerjes bruto në kohë reale); dhe

ii) për çdo monedhë tjetër, një ditë pune normale kur bankat janë hapur në qendrat financiare kryesore të monedhës në fjalë.

5.02 Marrëveshja e numërimit të ditëve

Çdo shumë për t’u paguar nga ana e Huamarrësit në bazë të kësaj kontrate për sa i përket interesit, dëmshpërblimit ose tarifës, llogaritur në nënndarje të vitit, do të përcaktohet mbi bazën e marrëveshjeve të mëposhtme:

i) për një këst me normë fikse interesi, një vit me treqind e gjashtëdhjetë ditë (360) dhe një muaj me tridhjetë (30) ditë; dhe

ii) për një këst me normë interesi variabël e shtrirje fikse fiks një vit me treqind e gjashtëdhjetë ditë (360) (por treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë (i pandryshueshëm) për GBP) dhe numri i ditëve të shkuara.

5.03 Koha dhe vendi i pagesës

Çdo shumë përveç interesit, dëmshpërblimit dhe principalit paguhet brenda shtatë (7) ditëve nga marrja nga ana e Huamarrësit e kërkesës së Bankës.

Çdo shumë për t’u paguar nga Huamarrësi sipas kësaj kontrate, do të paguhet në llogarinë përkatëse të njoftuar Huamarrësit nga ana e Bankës. Banka tregon numrin e llogarisë jo me pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para kryerjes së pagesës së parë të parashikuar nga Huamarrësi dhe do të njoftojë në lidhje me çdo ndryshim numri llogarie jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së pagesës së parë për të cilën aplikohet ndryshimi. Periudha e lajmërimit nuk aplikohet në rast kryerje pagese sipas nenit 10.

Shuma për t’u paguar nga ana e Huamarrësit konsiderohet e paguar në momentin kur Banka e merr atë.

Neni 6 Zotimet

Përdorimi i huasë dhe i fondeve të tjera në dispozicion

Huamarrësi do t’i përdorë të ardhurat e huasë vetëm për zbatimin e projektit.

Huamarrësi do të garantojë disponueshmërinë e fondeve të tjera të listuara në pikën (2), si dhe që këto fonde të shpenzohen, sipas hapësirave të nevojshme, për financimin e projektit.

Zbatimi dhe përfundimi i projektit

Huamarrësi do të sigurojë që agjencia mbështetëse t’i dorëzojë Bankës brenda datës 15 shtator të çdo viti, duke filluar nga viti 2007, një raport mbi veprimtaritë e parashikuara për vitin e ardhshëm kalendarik (që këtej e tutje referuar si “Programi vjetor i reformës” ose “ARP”) në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën. ARP do të hartohet nga agjencia përgjegjëse, në përputhje me procedurat e përcaktuara në POM.

Huamarrësi do të sigurojë që agjencia mbështetëse të zbatojë projektin në përputhje me POM dhe pasqyrën A, e cila mund të pësojë ndryshime të herëpashershme me aprovimin e Bankës dhe ta përfundojë atë brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në pasqyrën A.

Kostoja e rritur e projektit

Nëse kostoja e përgjithshme e projektit tejkalon shumën e përlllogaritur në pikën (2), Huamarrësi do të sigurojë financimin e nevojshëm për koston shtesë, pa kërkuar ndihmën e Bankës, në mënyrë që projekti të zbatohet dhe përfundojë në përputhje me POM dhe përshkrimin teknik. Planet e hartuara nga Huamarrësi për financimin e koston shtesë do t’i dorëzohen Bankës për informacion brenda afateve të caktuara kohore.

Procedura e prokurimit

Agjencia mbështetëse garanton dhe merr përsipër kundrejt Bankës që të gjitha punimet, mallrat dhe shërbimet e nevojshme për projektin, sikurse deri tani ashtu edhe në të ardhmen, do të porositen, blihen dhe sigurohen nëpërmjet një tenderi të hapur ndërkombëtar ose ndonjë procedure tjetër të pranueshme prokurimi në përputhje për Bankën, me POM.

Zotime të vazhdueshme gjatë projektit

Për sa kohë që huaja është e papaguar, Huamarrësi do të sigurojë që agjencia mbështetëse:

i) Mirëmbajtja: të mirëmbajë, të riparojë, të kontrollojë dhe të rinovojë të gjitha punimet dhe asetet që janë pjesë e projektit, në rast se kërkohet një gjë e tillë, në mënyrë që të mbahen në gjendje të rregullt pune, si dhe të sigurojë fondet e nevojshme për sa më sipër;

ii) Asetet e projektit: vetëm nëse Banka e ka dhënë pëlqimin e saj paraprak me shkrim, të ruajë të drejtën dhe zotërimin e të gjithë apo një pjese të mirë të të gjitha aseteve të projektit ose sipas rastit, të zëvendësojë dhe të rinovojë këto asete, si dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e vazhdueshme të projektit në përputhje me qëllimin e tij; Banka do të refuzonte pëlqimin e saj vetëm në rast se veprimtaria e propozuar do të cenonte interesat e Bankës si kreditore e Huadhënësit ose do ta bënte financimin e projektit të papranueshëm nga Banka, sipas statutit apo nenit 267 të Traktatit të Romës;

iii) Siguria: të sigurojë që të gjitha punimet dhe asetet që janë pjesë e projektit, nëpërmjet të cilit do të zbatohen, të jenë të siguruara sipas praktikave të zakonshme për punime të ngjashme të interesit publik;

iv) Të drejtat dhe autorizimet: të ruajë të gjitha të drejtat për mënyrën apo përdorimin, si dhe të gjitha autorizimet e nevojshme për zbatimin dhe operimin e projektit;

v) Mjedisi: të zbatojë dhe drejtojë projektin në përputhje me procedurat mjedisore të përcaktuara në POM; si dhe

vi) Ligjshmëria e përgjithshme: të zbatojë dhe të drejtojë projektin në përputhje me parimet ligjore të BE-së, të zbatueshme drejtpërdrejt tek Huamarrësi dhe projekti, sikurse gjen zbatim dhe në ligjet e Huamarrësit.

Paprekshmëria

Huamarrësi garanton dhe merr përsipër se nuk ka kryer dhe nuk do të kryejë, dhe asnjë person tjetër, me autorizimin apo dijeninë e tij, nuk do të kryejë asnjë nga veprimtaritë e mëposhtme:

i) Të ofrojë, të japë, të marrë apo të kërkojë çdo lloj avantazhi të papërshtatshëm për të influencuar veprimet e kujtdo personi me një funksion zyrtar publik apo një drejtori ose punonjësi të një organizate publike ndërkombëtare, në lidhje me çfarëdo procesi prokurimi apo në zbatimin e çdo lloj kontrate lidhur me ato elemente të projektit, të paraqitur në përshkrimin teknik; ose

ii) Çdo veprim, i cili ndikon apo ka për qëllim të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme në procesin e prokurimit apo në zbatimin e projektit, në dëm të Huamarrësit, përfshirë këtu marrëveshje të fshehta midis tenderuesve.

Për këtë qëllim, çdo informacion, për të cilin është në dijeni ministri, zëvendësministri, asistenti apo këshilltari i ministrit, menaxheri apo ndonjë anëtar i stafit të projektit, do të konsiderohet si informacion i disponueshëm edhe nga Huamarrësi. Huamarrësi merr përsipër të informojë Bankën nëse do të vihet në dijeni të ndonjë fakti apo informacioni lidhur me kryerjen e ndonjë veprimi të tillë.

Neni 7

Norma e njëjtë

Nëse Huamarrësi i garanton një pale të tretë sigurinë mbi përmbushjen e çdo detyrimi, borxhi të jashtëm apo të çdo preference ose përparësie lidhur me të, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe nëse kërkohet nga Banka, do t'i sigurojë asaj po të njëjtën siguri mbi përmbushjen e detyrimeve të tij ose do t'i garantojë Bankës po ato preferenca dhe përparësi. Huamarrësi cilëson se nuk ekziston asnjë siguri, preferencë apo përparësi e tillë.

Asgjë e përmendur në paragrafin e mësipërm nuk do të përbëjë barrë apo pengesë për shitësin apo ndonjë pengesë tjetër për toka ose asete të tjera, kur një pengesë e tillë siguron vetëm çmimin e blerjes apo çdo kredi, me një afat kohor prej jo më shumë se 12 muajsh, i siguruar për financimin e tij ose (ii) një peng mbi rezervat, i krijuar për të siguruar çdo kredi afatshkurtër.

Neni 8 Informacionet dhe vizitat

8.01 Informacionet lidhur me projektin:

Huamarrësi:

i) do t'i dorëzojë Bankës (a) informacion në përmbajtje dhe formë, si dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në POM dhe/ose në pasqyrën A.2 ose siç është rënë dakord nga palët e kësaj kontrate, dhe (b) çdo informacion apo dokument tjetër rreth financimit, prokurimit, zbatimit, operimit dhe ndikimit mjedisor lidhur me projektin, sipas kërkesave të arsyeshme të Bankës;

ii) do t'i dërgojë menjëherë Bankës për miratim çdo ndryshim material lidhur me çmimin, hartimin e projektit, planet, planifikimin e afateve apo shpenzimeve për projektin, në varësi të evidencave të dhëna Bankës para nënshkrimit të kësaj kontrate;

iii) do t'i sigurojë Bankës, nëse kërkohet: (a) një vërtetim të shoqërive të tij të sigurimit, ku paraqitet përmbushja e kërkesave të paraqitura në nenin 6.05; (b) çdo vit, një listë të politikave në fuqi, lidhur me asetet e siguruara të projektit, së bashku me konfirmimin e pagesave aktuale të kësteve të sigurimit;

iv) do të informojë menjëherë Bankën për: (a) çdo çështje gjyqësore të hapur apo të kanosur ndaj tij, lidhur me çështje mjedisore apo të tjera që cenojnë projektin; ose (b) çdo fakt apo ngjarje për të cilën Huamarrësi është në dijeni, që mund të cenojë apo ndikojë në kushtet e zbatimit apo operimit të projektit;

v) duke filluar nga viti 2008, do t'i dërgojë Bankës çdo vit një raport operacional lidhur me projektin, i cili do të përpilohet nga auditues të pavarur të pranueshëm për Bankën;

vi) duke filluar nga viti 2008, do t'i dorëzojë Bankës çdo vit, brenda një afati gjashtëmuor nga mbarimi i çdo viti fiskal, deklarata financiare të programeve të audituara lidhur me projektin;

vii) duke filluar nga viti 2007, do t'i dorëzojë Bankës çdo 15 mars të viteve në vazhdim, një raport mbi performancën e ARP-së përkatëse të vitit të shkuar kalendarik. Një raport i tillë do të hartohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në POM;

viii) duke filluar nga viti 2007, do t'i dorëzojë Bankës dy herë në vit raporte financiare monitoruese të hartuara në përputhje me procedurat e përcaktuara në POM; si dhe

ix) do t'i dorëzojë Bankës brenda një afati gjashtëmuor pas përfundimit të zbatimit të projektit, një raport që të paraqesë përfundimin e plotë të projektit. Ky raport do të hartohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në POM.

8.02 Informacionet lidhur me Huamarrësin

Huamarrësi do të informojë Bankën:

i) për çdo rast që mund të pengojë Huamarrësin në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas nenit 7;

ii) për çdo vendim që merr për kryerjen e një parapagese të huasë me afat;

iii) menjëherë, për çdo fakt që e detyron atë dhe për çdo kërkesë drejtuar atij për të parapaguar plotësisht ose pjesërisht, në rast mospagimi brenda afatit, çdo hua të dhënë nga një palë e tretë ose për të njëjtat arsye të shlyejë përpara afatit çdo detyrim që del si rrjedhojë e një transaksioni financiar ose ndonjë pjesë të tij; si dhe

iv) përgjithësisht për çdo fakt apo ngjarje që do të pengonte përmbushjen e çdo detyrimi të Huamarrësit sipas kësaj kontrate.

8.03 Vizitat nga Banka

Për sa kohë që huaja të jetë e papagueshme, agjencia mbështetëse do të sigurojë që personat e caktuar nga Banka, të cilët mund të shoqërohen nga përfaqësues të Gjykatës së Audituesve të Komuniteteve Europiane, do të lejohen të kryejnë vizita në terren dhe të ushtrijnë kontrolle të tilla sipas dëshirës. Për këtë qëllim agjencia mbështetëse do t'u sigurojë këtyre personave dhe përfaqësuesve, të gjithë asistencën e nevojshme.

8.04 Hetimet dhe informacionet

Huamarrësi merr përsipër:

i) që sipas kërkesës së arsyeshme të Bankës, të hetojë dhe/ose t'i japë fund çdo veprimi të supozuar apo dyshuar të një natyre siç përshkruhet në nenin 6.06;

ii) të informojë Bankën për masat e marra për kërkimin e dëmshpërblimeve nga personat përgjegjës për çdo humbje që mund të sjellë një veprim i tillë; si dhe

iii) të lehtësojë çdo hetim që Banka mund të kryejë për një veprim të tillë.

Nëse Huamarrësi nuk i specifikon Bankës me shkrim të kundërtën, ai (Huamarrësi) do të jetë përgjegjës për kontaktimet me Bankën për qëllimet e specifikuara në nenin 6.06.

Neni 9

Detyrimet dhe shpenzimet

9.01.1 Taksat, tatimet dhe tarifat

Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat, tatimet, tarifatat dhe detyrimet e tjera të çdo natyre, përfshirë pullat e taksës dhe tarifatat e regjistrimit, të cilat dalin nga ekzekutimi apo zbatimi i kësaj kontrate apo i çdo dokumenti tjetër lidhur me të, si dhe në krijimin e çdo lloji sigurimi për huanë sipas shtyrjes së zbatueshme.

Huamarrësi do të paguajë të gjithë principalin, interesat, dëmshpërblimet dhe shumatat e tjera sipas kësaj kontrate, bruto pa zbritjen e asnjë takse kombëtare apo lokale që nëse Huamarrësi është i detyruar të bëjë zbritje të tilla, pagesa që do të bëjë në Bankë duhet të bëhet në mënyrë të tillë që, edhe pas këtyre zbritjeve, shumata neto që do të marrë Banka të jetë e barasvlefshme me shumën e caktuar për t'u paguar.

9.02 Detyrime të tjera

Huamarrësi do të përballojë të gjitha detyrimet dhe shpenzimet, përfshirë detyrimet profesionale, bankare apo të kursit të këmbimit që dalin gjatë zbatimit të kësaj kontrate ose çdo dokumenti të ngjashëm, përfshirë ndonjë amendament në lidhje me të, si dhe në krijimin, menaxhimin apo realizimin e çdo lloji sigurimi për huanë, nëse ka, si dhe shpenzime të tjera të Bankës siç përcaktohen në nenin 8.04.

Banka do të mbështesë me dokumente të tilla për ndonjë prej këtyre detyrimeve apo shpenzimeve, shtatë ditë para kërkesës së saj për pagesën e tyre.

Neni 10

Parapagimi në rast të moskryerjes së pagesës në kohë

10.01 E drejta për të kërkuar ripagim

Huamarrësi do të ripaguajë huanë apo çdo pjesë të saj menjëherë, bashkë me interesat e shtuara të saj, pas një kërkesë me shkrim të bërë nga Banka për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

10.01.1 Kërkesa e menjëhershme

Banka mund të bëjë menjëherë një kërkesë të tillë, në rastet e mëposhtme:

i) nëse Huamarrësi nuk arrin të ripaguajë brenda afatit përfundimtar çdo pjesë të huasë, të paguajë interesat e shtuara të kësaj huaje apo të kryejë çdo pagesë tjetër Bankës siç specifikohet këtu;

ii) nëse Huamarrësi nuk arrin të përmbushë detyrimet financiare të çdo huaje tjetër (të ndryshme nga huaja) që i është dhënë nga Banka dhe nëse, si pasojë e çdo mospagese si rrjedhojë e kësaj, Huamarrësi do të parapaguajë çdo hua tjetër ose do të shlyejë para afatit çdo detyrim që del si rrjedhojë e një transaksioni financiar;

iii) nëse, si pasojë e një dështimi nga ana e Huamarrësit, në përmbushjen e çdo detyrimi lidhur me huatë e specifikuara në pikën (2) apo të çdo granti të akorduar nga Bashkimi Europian, e drejta e Huamarrësit për të tërhequr pjesërisht ose plotësisht të ardhurat e këtyre huave apo granteve do të anulohet apo pezullohet, ose nëse ajo hua apo grant është bërë e pagueshme në bazë të kushteve respektive;

iv) nëse Huamarrësi nuk arrin të përmbushë detyrimet e MOU-t;

v) nëse ndonjë informacion apo dokument i dorëzuar Bankës nga ose në emër të Huamarrësit gjatë bisedimeve për këtë kontratë, ose gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, rezulton i pasaktë në ndonjë detaj material; ose

vi) përgjithësisht, nëse ndodh diçka apo krijohet ndonjë situatë që mund të vërë në rrezik dorëzimin e huasë apo që cenon seriozisht çdo siguri që lidhet me të.

10.01.2 Kërkesa pas njoftimit për rishikim

Banka mund të bëjë një kërkesë të tillë në lidhje me çështjen e parashikuar, brenda një periudhe kohore të arsyeshme, të specifikuar në një njoftim të Bankës drejtuar Huamarrësit:

i) nëse Huamarrësi nuk arrin të përmbushë çdo detyrim material nën këtë kontratë, i cili nuk përfshihet si detyrim në nenin 10.01(1)(i); ose

ii) nëse ndonjë prej fakteve të deklaruara në pikat e kësaj kontrate ndryshohet materialisht dhe nuk rishikohet materialisht, si dhe nëse ky ndryshim cenon interesat e Bankës si huadhënës ndaj Huamarrësit ose nëse cenon seriozisht zbatimin ose operimin e projektit.

10.02 Të drejta të tjera të parashikuara me ligj

Neni 10.01 nuk do të kufizojë asnjë të drejtë tjetër që Banka gëzon me ligj për të kërkuar parapagimin e huasë.

10.03 Dëmshpërblimi

10.03(1) Këstet me normë fikse

Në rast të një kërkesë sipas nenit 10.01 lidhur me çdo normë fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar së bashku me një shumë të përlllogaritur sipas nenit 4.02(2)(i) për çdo shumë për t'u paguar. Kjo shumë do të rritet që nga data e përcaktuar në njoftimin e Bankës për pagesën e saj dhe do të llogaritet mbi bazën e datës në të cilën është kryer parapagesa.

10.03.1 Këstet FSFR (shtrirje kohore fikse dhe interes variabël)

Në rast të një kërkesë sipas nenit 10.01 lidhur me një këst FSFR, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar bashkë me një shumë të barabartë me vlerën aktuale prej 0.15% (15 pikë bazë) në vit, të përlllogaritura dhe të rritura në bazë të shumës që duhej paguar në të njëjtën mënyrë si të ishte përlllogaritur dhe rritur interesi, nëse shuma do të kishte mbetur e papaguar sipas planit fillestar të shlyerjes së këstit.

Kjo vlerë aktuale do të llogaritet duke përdorur një interes me zbritje, të aplikuar si për çdo datë pagese përkatëse. Interesi me zbritje do të jetë interesi fiks i aplikueshëm një muaj përpara datës së parapagesës dhe me të njëjtat kushte për pagesën e interesit, dhe me të njëjtin afat të datës së maturimit.

10.03.2 Të përgjithshme

Shumat e pagueshme nga Huamarrësi, sipas këtij neni 10.03, do të paguhën në datën e parapagesës të specifikuar në kërkesën e Bankës.

10.04 Mosheqja dorë

Asnjë dështim apo vonesë nga ana e Bankës në ushtrimin e të drejtave të saj sipas nenit 10, nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë.

10.05 Aplikimi i shumave të marra

Shumat e marra nga Banka, në bazë të një kërkesë sipas nenit 10.01, do të përdoren, së pari, për pagimin e shpenzimeve (nëse ka), të interesave dhe të dëmshpërblimeve, dhe së dyti, për reduktimin e kësteve të papaguara në rend të anasjellë maturimi. Banka mund t'i përdorë shumat e marra nëpërmjet kësteve sipas dëshirës së saj.

Neni 11

Gjuha, ligjshmëria dhe jurisdiksioni

11.01 Gjuha

Çdo dokument, njoftim ose komunikim midis Palëve të kësaj kontrate do të bëhet në gjuhën angleze ose do të shoqërohet nga një përkthim i certifikuar sipas rregullave në gjuhën angleze.

11.02 Ligjshmëria

Kjo kontratë bazohet në legjislacionin e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

11.03 Juridiksioni

Mosmarrëveshjet që dalin nga kjo kontratë do t'i parashtrohen Gjykatës së Drejtësisë të vendeve të Komunitetit European.

Palët në këtë kontratë heqin dorë nga çdo formë imuniteti ose e drejte për të kundërshtuar juridiksionin e kësaj Gjykate. Çdo vendim i Gjykatës, i marrë sipas këtij neni 11.03, është përfundimtar dhe detyrues për Palët pa kufizim dhe rezervë.

11.04 Prova të shumave për t'u paguar

Në çdo akt ligjor që lind nga kjo kontratë, vërtetimi i Bankës në lidhje me shumat që do t'i paguhën Bankës sipas kësaj kontrate, do të jetë fakt i kësaj shume.

Neni 12

Dispozita përfundimtare

12.01 Njoftimet ndaj Palëve

Njoftimet dhe komunikimet e tjera të dhëna palëve në këtë kontratë do të kryhen me shkrim dhe do të nisen në adresat e mëposhtme ose në një adresë tjetër pasi Pala tjetër të jetë njoftuar me shkrim:

Për Bankën

100 Boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

Për Huamarrësin

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr.1

Tirana

Albania (Shqipëri)

Faks: +355 4258435

12.02 Forma e njoftimit

Njoftimet dhe komunikimet e tjera, për të cilat janë vendosur shtrirje kohore në këtë kontratë ose që vetëcaktjnë shtrirje kohore detyruese për marrësin, do të dorëzohen dorazi, me postë rekomande, faksimile ose me mjete të tjera dërgimi që mund të merren si prova marrjeje nga ana e dërguesit. Data e regjistrimit ose, sipas rastit, data e përcaktuar e marrjes është vendimtare për përcaktimin e kohës.

Njoftimet e lëshuara nga Huamarrësi sipas dispozitave të kësaj kontrate, kur kërkohet nga Banka, do t'i dorëzohen Bankës së bashku me prova të mjaftueshme të autoritetit të personit apo personave të autorizuar për të nënshkruar një njoftim të tillë në emër të Huamarrësit dhe mostra të vërtetuara të firmave të personit apo personave të tillë.

12.03 Pikat, pasqyrat dhe shtojcat

Pikat dhe pasqyrat e mëposhtme janë pjesë e kësaj kontrate:

Pasqyra A.1

Përshkrimi teknik

Pasqyra A.2

Informacion mbi projektin që do t'i përcillet

Bankës dhe metoda e transmetimit

Pasqyra B

Përkufizimet e EURIBOR-it dhe LIBOR-it

Pasqyra C

Formulari i kërkesës për disbursim

Në dëshmi të kësaj, Palët kanë vendosur inicialet e tyre në çdo faqe të kësaj kontrate të përpiluar në tre kopje origjinale në gjuhën angleze si më poshtë.

/ /2006

Nënshkruar për dhe në emër të
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

.....

Nënshkruar për dhe në emër të
BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE

Zv. Presidenti

.....

G. Genuardi

Pasqyra A.1

PËRSHKRIMI TEKNIK

Qëllimi, vendi

Objektivat e projektit konsistojnë në përmirësimin e cilësisë së kushteve të mësimit për nxënësit, rritjes së regjistrimeve në shkollat e mesme të përgjithshme dhe një drejtimi më të mirë të arsimit të lartë. Mbështetja do të fokusohet në: (i) forcimin e drejtimit, menaxhimit dhe rregullimit të sistemit arsimor; (ii) rritjen e cilësisë së rezultateve të procesit mësimor; (iii) zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës arsimore, veçanërisht asaj të arsimit të mesëm; dhe (iv) përgatitjen e terrenit për reformën në arsimin e lartë.

Veprimtaria e projektit do të zhvillohet në Shqipëri.

Përshkrimi

Programi përfshin katër fusha prioritare. Prioriteti i parë i programit është forcimi i drejtimit, kapaciteteve menaxhuese dhe rregullimit të sistemit arsimor. Disa nga veprimtaritë që janë pjesë e këtij prioriteti kanë të bëjnë me zhvillimin profesional të drejtorëve të shkollave, futjen e një sistemi të bazuar në performancë, si dhe përdorimi i një sistemi informativ të menaxhimit të arsimit për vendim marrje. Prioriteti i dytë ka të bëjë me përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të të mësuarit dhe do të trajtojë çështje të zhvillimit të një kurrikule kombëtare, përmirësimit të teksteve dhe zhvillimit profesional të mësuesve. Prioriteti i tretë ka lidhje me përmirësimin dhe racionalizimin e infrastrukturës arsimore, veçanërisht asaj të arsimit të mesëm, dhe do të mbështesë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) në zhvillimin dhe implementimin e një inventarizimi të detajuar të shkollave dhe do të përfshijë sigurimin e laboratorëve shkencorë dhe mjediseve kompjuterike në shkollat e arsimit të mesëm në përputhje me kurrikulin e ri. Prioriteti i katërt dhe i fundit ka të bëjë me përgatitjen e terrenit për reformën në arsimin e lartë dhe mbështet MASH për të realizuar një rishikim të sistemit, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e veprimtarive në arsimin e lartë.

Afati

Projekti do të zbatohet gjatë periudhës 2007-2010.

Pasqyra A.2

INFORMACION MBI PROJEKTIN QË DO T'Ë PËRCILLET BANKËS DHE METODA E TRANSMETIMIT

1. Dërgimi i informacionit: përcaktimi i një personi përgjegjës

Informacioni i mëposhtëm duhet t'ë nisat Bankës nën përgjegjësinë e:

Kompania	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Personi kontaktues	Z. Antonieta Luli
Pozicioni	Sekretare e Përgjithshme
Funksioni/departamenti	
Adresa	Tirana
Telefon	+355 4 22 63 07
Faks	+355 4 23 20 02
Email	aluli@mash.gov.al

Personi/at e lartpërmendur të kontaktit është/janë aktualisht përgjegjës kontakti.

Huamarrësi do të informojë EIB menjëherë në rast se do të ketë ndonjë ndryshim.

2. Të dhëna mbi çështje specifike

Huamarrësi do t'ë përcjellë Bankës informacionin e mëposhtëm maksimumi brenda afatit të treguar më poshtë.

Dokumenti/informacioni	Afati
Programi i reformës vjetore	Të paraqitet çdo vit, jo më vonë se 15 shtatori, përveç raportit të parë që do të dorëzohet brenda 15 nëntorit 2006. Raporti i fundit do të dorëzohet në 2009, për vitin kalendarik 2010. Format i raportit jepet i detajuar në manualin operacional të projektit.

3. Të dhëna mbi zbatimin e projektit

Agjencia mbështetëse, ndër të tjera do të përgatisë dhe dorëzojë: (i) raporte ecurie dhe (ii) raporte monitorimi financiar partnerëve të zhvillimit, siç specifikohen në formë dhe përmbajtje në manualin operacional të projektit (POM). Raportet e monitorimit financiar do të paraqiten dy herë në

vit dhe do të përmbajnë të dhëna mbi: (i) rezultatet reale kundrejt atyre të planifikuara dhe arritjet e projekteve; (ii) aktivitetin financiar; (iii) veprimtaritë prokuruese.

Revizorët e pavarur do të kryejnë çdo vit një kontroll operacional, duke mbuluar strukturat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe proceset e prokurimit.

4. Të dhëna në fund të veprimtarisë zbatuese dhe operimit të vitit të parë

Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës një raport mbi përfundimin e projektit në gjuhën angleze me afat të fundit datën 30 qershor 2011, siç specifikohet në formë dhe përmbajtje në manualin operacional të projektit.

Pasqyra B

PËRKUFIZIMET E EURIBOR-IT DHE LIBOR-IT

A. EURIBOR-i

“EURIBOR” nënkupton:

- për sa i përket çdo periudhe përkatëse, përfshirë një periudhë reference me shtrirje fikse dhe normë interesi variabël ose çdo periudhë tjetër një mujore ose më shumë, norma e interesit për depozitat në euro për një periudhë të përbërë nga numri i muajve të plotë që korrespondojnë më afër me kohëzgjatjen e periudhës; dhe

- për sa i përket një periudhe përkatëse më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në euro për një afat kohor një mujor;

(periudha për të cilën përcaktohet norma, këtu e tutje referuar si “Periudha përfaqësuese”), publikuar në orën 11:00 paradite sipas orës së Brukselit ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme nga Banka ditën (data e rivendosjes), që përkon me dy ditë pune zyrtare përkatëse para ditës së parë të periudhës në fjalë, në faqen e Reuters-it EURIBOR 01 ose në faqen pasuese ose çdo mënyrë tjetër publikimi përcaktuar nga Banka për këtë qëllim.

Në rast se kjo normë nuk publikohet në mënyrë të tillë, Banka iu kërkon zyrtarëve kryesorë të eurozonës të katër bankave kryesore të eurozonës, të zgjedhura nga Banka, të kuotojnë normën ofruar shumëve të ngjashme rreth orës 11:00 paradite, me orën e Brukselit, në datën e rivendosjes, në tregun ndërbankar të eurozonës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kuotime, norma për atë datë rivendosjeje do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

Nëse sigurohen siç kërkohet më pak se dy kuotime, norma për datën e rivendosjes do të jetë mesatarja aritmetike e normave të kuotuar nga bankat kryesore në eurozonë, përzgjedhur nga Banka, rreth orës 11:00 paradite me orën e Brukselit në ditën që përkon me dy ditë pune zyrtare përkatëse pas datës së rivendosjes, për huatë në euro në shuma të ngjashme me bankat kryesore europiane për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

B. LIBOR USD

Për sa i përket USD, “LIBOR” nënkupton:

- për sa i përket çdo periudhe përkatëse, përfshirë një periudhë reference me shtrirje fikse dhe normë interesi variabël ose çdo periudhë tjetër një mujore; ose

- më shumë, norma e interesit për depozitat në euro për një periudhë të përbërë nga numri i muajve të plotë që korrespondojnë më afër me kohëzgjatjen e periudhës; dhe

- për sa i përket një periudhe përkatëse më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në USD për një afat kohor një mujor;

(periudha për të cilën përcaktohet norma, këtu e tutje referuar si “Periudha përfaqësuese”) vendosur nga Shoqata e Bankierëve Britanikë dhe publikuar nga kanalet e lajmeve financiare në orën 11:00 paradite sipas orës së Londrës ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme nga Banka ditën (“Data e rivendosjes”), që përkon me dy ditë pune zyrtare londineze para ditës së parë të periudhës në fjalë.

Në rast se kjo normë nuk publikohet në mënyrë të tillë nga kanalet e lajmeve financiare të pranueshme për Bankën, Banka u kërkon zyrtarëve kryesorë të Londrës të katër bankave kryesore në tregun ndërbankar të Londrës, të përzgjedhura nga Banka, të kuotojnë normën ofruar depozitave të ngjashme në USD rreth orës 11:00 paradite, me orën e Londrës në datën e rivendosjes, në bankat kryesore në tregun ndërbankar të Londrës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

Nëse sigurohen të paktën dy kuotime, norma do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

Nëse sigurohen siç kërkohet më pak se dy kuotime, Banka do t'i drejtohet zyrove kryesore të Nju-Jorkut të katër bankave kryesore në tregun ndërbankar të Nju-Jorkut, përzgjedhur nga Banka, për të kuotuar normën e ofruar prej tyre depozitave të ngjashme rreth orës 11:00 paradite me orën e Nju-Jorkut në ditën që përkon me dy ditë pune zyrtare njujorkeze pas datës së rivendosjes, në bankat kryesore në tregun evropian për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kuotime, norma do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

C. LIBOR GBP

Për sa i përket GBP, "LIBOR" nënkupton:

- në lidhje me çdo periudhë përkatëse, përfshirë një periudhë reference me shtrirje fikse dhe normë interesi variabël ose çdo periudhë tjetër njëmuore ose më shumë, norma e interesit për depozitat për një periudhë të përbërë nga numri i muajve të plotë që korrespondojnë më afër me kohëzgjatjen e periudhës; dhe

- në lidhje me një periudhë përkatëse më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në GBP për një afat kohor njëmuor;

(periudha për të cilën përcaktohet norma, këtu e tutje referuar si "Periudha përfaqësuese");

siç është vendosur nga Shoqata e Bankierëve Britanikë dhe publikuar nga kanalet e lajmeve financiare në orën 11:00 paradite sipas orës së Londrës ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme nga Banka ditën ("Data e rivendosjes") në të cilën periudha në fjalë fillon, nëse ajo ditë nuk përkon me ditë pune zyrtare londineze, ditën pasardhëse, e cila përkon me një ditë zyrtare pune.

Në rast se një normë nuk publikohet në mënyrë të tillë nga kanalet e lajmeve financiare të pranueshme për Bankën, Banka iu kërkon zyrove kryesore të Londrës të katër bankave kryesore në tregun ndërbankar të Londrës, të përzgjedhura nga Banka, të kuotojnë normën ofruar depozitave të ngjashme në GBP rreth orës 11:00 paradite, me orën e Londrës në datën e rivendosjes, në bankat kryesore në tregun ndërbankar të Londrës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kuotime, norma do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

Nëse sigurohen siç kërkohet më pak se dy kuotime, norma do të jetë mesatarja aritmetike e normave të kuotuar rreth orës 11:00 paradite me orën londineze në datën e rivendosjes nga bankat kryesore në Londër (përzgjedhur nga Banka) për huatë në GBP në një shumë të krahasueshme me bankat kryesore evropiane për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

D. Të përgjithshme

Për qëllime të përkufizimeve të mësipërme

"Ditë pune zyrtare londineze" nënkupton një ditë në të cilën bankat janë hapur për veprimtari normale në Londër dhe "Ditë pune zyrtare njujorkeze" nënkupton një ditë në të cilën bankat janë hapur për veprimtari normale në Nju-Jork.

Të gjitha përqindjet që rezultojnë nga llogaritjet e përcaktuara në këtë pasqyrë do të rrumbullakosen, nëse është e nevojshme, me afërsi 100/1000 e një pike përqindjeje, duke rrumbullakosur gjysmat.

Banka do të informojë Huamarrësin pa vonesë për kuotimet e marra prej saj.

Nëse një nga dispozitat e mësipërme nuk është në pajtim me dispozitat e pranuar brenda kuadrit të EURIBOR FBE dhe EURIBOR ACI për sa i takon EURIBOR ose Shoqatës së Bankierëve Britanikë për sa i takon LIBOR, Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund ta amendojë dispozitën për ta bërë të pajtueshme me dispozitat e tjera.

Pasqyra C

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

Kërkesa për disbursim

Nr. i kështit:

Data:

Ju lutem vazhdoni me disbursimin e mëposhtëm:

Emërtimi i huasë (*): Hua për zhvillimin e arsimit

Rezervuar për EIB

Data e firmosjes (*): / 2006

Numri i referencës: 1

Disbursimi nr.:

Shuma e kredisë: 12.500.000 EURO

Data e propozuar

Disbursuar deri tani:

për disbursim:

Bilanci i disbursimeve:

Totali i kërkuar

Afati i kërkesës për disbursim: 31/12/2009

(monedha e kontratës):

Nr. maksimal i disbursimeve:

Min. i shumës së kështit: 2.000.000 EUR

Nr. total i alokimeve deri tani:

Kushtet bazuar në: Nenin 1.04

Të disbursohet si më poshtë

Monedha (Neni 1.03)

Shuma

Baza e normës së interesit

Normë fikse

Norma e interesit/shtrirja (Neni 3.01)

FSFR

Periodiciteti i

Gjashtëmujor

interesit (Neni 3.01)

Vjetor

Shlyerja (Neni 4.01)

Këste vjetore konstante ose

Këste të barabarta të kapitalit

Datat e shlyerjes (Neni 5.01)

Data e parë e shlyerjes

Data e fundit e shlyerjes

Llogari e huamarrësit që duhet të kreditohet:

Nr. i llogarisë:

Emri i Bankës dhe adresa:

Ju lutem drejtoni çdo informacion në lidhje me kërkesën në:

Emri/at dhe firma/at e autorizuar të Huamarrësit:

LIGJ

Nr.9666, datë 18.12.2006

**PËR RATIFIKIMIN E NJË NDRYSHIMI NË “MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MISIONIT TË ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË
KOSOVË (UNMIK), NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME
VETËQEVERISËSE TË KOSOVËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të

¹ Referoju faqes në lidhje me kontratën

Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi në “Marrëveshjen e tregtisë së lirë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në emër të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5175, datë 28.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KOMITETI I PËRBASHKËT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
UNMIK/KOSOVË, NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRBASHKËTA VETËQEVERISËSE
TË KOSOVËS

Amendament nr.1

Në mbështetje të neneve 30 paragrafi 3 dhe 36 të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe UNMIK/Kosovë, në emër të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës,

KOMITETI I PËRBASHKËT

VENDOSI:

1. Tarifat doganore mbi importet produkteve industriale, të aplikueshme në Kosovë mbi produktet industriale me origjinë nga Republika e Shqipërisë, të specifikuara në aneksin III të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe UNMIK/Kosovë, do të eliminohen, në datën e hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, por jo para datës 1 janar 2007.

2. Tarifat doganore mbi importet e produkteve bujqësore, të aplikueshme në Republikën e Shqipërisë dhe në Kosovë, do të eliminohen, në datën e hyrjes në fuqi të këtij amendamenti.

Z.Genc Ruli
Kryetar i Delegacionit Shqiptar

Z.Bujar Dugolli
Bashkëkryetar i Komitetit të Përbashkët
Z. Andreas Wittkowsky
Kryetar i Delegacionit të UNMIK

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
...	
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Doli nga shtypi më 17.1.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2007

Çmimi 48 lekë